

LE MONDE. *shqip* diplommatique

Editorial

Kush do do të jetë armiku i radhës?

Nga Serge Halimi

/ Faqe 4

Nr. 800 / Viti i 67 i botimit / Dhjetor 2020

BALLKANI MIDIS FRYMËS SË NDRYSHIMEVE DHE (MOS)PERSPEKTIVËS EVROPIANE

Udhëkryqi i vendnumërimit ballkanik



INTERVISTUAN: SHKODRAN HOTI DHE BELGZIM KAMBERI

Përderisa rënia e Donald Trump nga pushteti pritet ta ritkëjë bashkëpunimin transatlantik dhe koordinimin midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian, perspektiva evropiane e Ballkanit perëndimor mbetet e zymtë, edhe për shkak të vetë Bashkimit Evropian. Paralelisht, një frymë e ndryshimeve politike po fryn në vendet e rajonit. Pas Maqedonisë së Veriut dhe Malit të zi, Kosova është në prag të ndryshimit të establishmentit njëzetëvjeçar qeveritar, ku pritet fitorja e Lëvizjes Vetëvendosje. Kjo pasi dështoi arritja e një marrëveshje të “madhe” politike, të paralajmëruar midis Kosovës dhe Serbisë. Se çfarë nënkuptojnë këto zhvillime aktuale dhe çfarë pritet në të ardhmen e afërt, /Faqe 2-3-4

KUR CITY OF LONDON MILITONTE PËR BREXIT

Epoka e financave autoritare



"Çmenduri", "gabim", "lëvizje pokeri" ... Që nga referendumi i vitit 2016, Brexit është paraqitur shpeshherë si rezultat i një kombinimi fatkeq të rrethanave. Megjithatë, ai i përgjigjet në mënyrë të përkryer, pritjeve të një pjese në rritje të sektorit të financave, që ndjehet ende shumë i kufizuar nga rregulloret evropiane.

NGA MARLÈNE BENQUET DHE THÉO BOURGERON*

Në mëngjesin e 24 qershorit 2016, bota zbuloi se në pyetjen: “A duhet që Mbretëria e Bashkuar të mbetet anëtare e Bashkimit Evropian apo të del prej saj?” 51.9% e votuesve u përgjigjën: « leave » (dalje). Për shumë, ky rezultat ishte një befasi:

City i fuqishëm, i përkëdheluri nga të gjitha pushtetet në Londër, dukej i bashkuar në favor të “remain” (qëndrim). Ç’ndodhi? A nuk kishin mjete të mjaftueshme punëdhënësit më të fuqishëm financiarë në Evropë që të dëgjohej zëri i tyre në një çështje që

ndikonte në të ardhmen e tyre? E zhurmshme, fushata e udhëhequr nga City në favor të “Remain” maskoi megjithatë një fushatë tjetër, më diskrete, por gjithsesi masive. Në të dhënat e bëra publike nga komisioni zgjedhor britanik gjejmë elemente

të cilat shpjegojnë në tri përfundime. Së pari, pothuajse dy të tretat e sektorit financiar investuan në referendum për ta mbështetur fushatën “Leave”, ndërsa nga ana e tyre, sektorët industrial investuan pothuajse gjysmën e kapitalit të tyre. Pastaj, 57% e /Faqe 7

Koment

Për një parti të re të majtë

Nga Leart Kola*

/Faqe 6

Gurët, që hidheshin lumë mbi policinë në ditën pas vrasjes së Klodianit në lagjen periferike të Laprakës, ishin të njëjtët me ato që hidheshin më 21 janar, apo dhe me ato që fluturonin mbi kokat e sampistëve të Ramiz Alisë në fillim të 90-ës e të Sali Berishës më pas. E vetmja gjë, që ndryshonte ishin duart, por mbase dhe

Aktivizëm

Qorrrokaku i politikave identitare

Nga Stéphane Beaud dhe Gérard Noiriel

/Faqe 5

Më 25 maj 2020 çështja racore u rishfaq papritmas në qendër të aktualitetit kur imazhet e vrasjes së George Floyd, të xhiruara nga një kalimtare me një telefon celular, u transmetuan pa ndërprerje në rrjete sociale dhe në kanalet e lajmeve

Vështrim

Pse e kemi të vështirë ta shkruajmë historinë tonë?!

Nga Ben Andoni

/Faqe 11

Pak ditë më parë, një profesori të Universitetit të Gjrokastrës i duhej ta bënte një përcapje të madhe ndër mediat tiranase për

Publicistikë

Mësimi i “Vargjeve Satanike”

Nga Laurent Binet

/Faqe 15

Bota ka ndryshuar, por kur? Jo më 11 shtator 2001, siç mund ta kishim menduar. Atë ditë, gjithçka tashmë kishte mbaruar. Në librin e tij « Përmbytja e qytetërimeve » Amin Maalouf kthehet në atë që ai e quan “kthimin e madh” më vitin 1979. Dhe duhet pranuar se kjo hipotezë ka mjaft argumente:

BALLKANI MIDIS FRYMËS SË NDRYSHIMEVE DHE (MOS)PERSPEKTIVËS EVROPIANE

Udhëkryqi i vendnumërimit ballkanik

Ndonëse fitorja e Joe Biden dhe ndryshimi i pushteteve në disa nga shtetet e rajonit shihen si mundësi e re për Ballkanin Perëndimor, integrimi evropian dhe paqja rajonale mbeten perspektiva të largëta.

INTERVISTUAN: SHKODRAN HOTI DHE BELGZIM KAMBERI

Përderisa rënia e Donald Trump nga pushteti pritet ta ritkhejë bashkëpunimin transatlantik dhe koordinimin midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian, perspektiva evropiane e Ballkanit perëndimor mbetet e zymtë, edhe për shkak të vetë Bashkimit Evropian. Paralelisht, një frymë e ndryshimeve politike po fryn në vendet e rajonit. Pas Maqedonisë së Veriut dhe Malit të zi, Kosova është në prag të ndryshimit të establishmentit njëzetëvjeçar qeveritar, ku pritet fitorja e Lëvizjes Vetëvendosje. Kjo pasi dështoi arritja e një marrëveshje të “madhe” politike, të paralajmëruar midis Kosovës dhe Serbisë. Se çfarë nënkuptojnë këto zhvillime aktuale dhe çfarë pritet në të ardhmen e afërt, bashkëbiseduam me dy specialistë ndërkombëtarë të Ballkanit; Florian Bieber, profesor dhe drejtor i Qendrës për Studime të Evropës Juglindore në Universitetin e Gracit në Austri; si dhe Jean-Arnault Dérens nga Parisi, historian, gazetar dhe kryeredaktor i portalit frankofon për Ballkanin, “Le Courrier des Balkans”.

– **Si e shihni perspektivën e sotme të procesit të anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian?**

Jean-Arnault Dérens : Objektivistisht ‘nulë’. Bashkimi Evropian nuk po del nga krizat e saj të shumëfishta. Nuk mund ta marrë parasysh në asnjë mënyrë integrimin e anëtarëve të rinj të zhvilluar dobët, të korruptuar, klientelistë dhe me institucione të dështuara. As nesër, as për pesë vjet, as për dhjetë vjet. Nëse çështja e anëtarësimit duhet të shqyrtohet realisht, kjo do të jetë në një Bashkim Evropian plotësisht të ripërtërirë, të rithemeluar; por kjo perspektivë nuk është për momentin në horizont.

Megjithëkëtë, të gjithë sillen « sikurse », thajse kjo perspektivë është ende reale, e sikurse ajo mund të ndryshojë ndonjë gjë... Nga ana e liderëve të korruptuar të Ballkanit, kjo shpjegohet lehtë : Vuçiqët, Dodikët, Edi Ramat dhe autokratët e tjerë të rajonit e kanë kuptuar mirë se procesi i integritetit është një iluzion tashmë që një kohë të gjatë. Andaj, ky proces nuk përfaqëson asnjë rrezik për ta dhe pushtetet e tyre. Nuk iu kërkohet asgjë, përpos që ta mbajnë një diskurs pro-evropian...Gjë që nuk është për ta ndonjë kosto e lartë! Autokratët e këndojnë këngën që Brukseli dëshiron ta dëgjojë dhe gjithkush mbetet i lumtur. Në qarqet evropiane, nuk janë më naiv se gjëkund, por meqë Bashkimi Evropian

nuk ka asgjë konkrete për t’i propozuar shteteve të Ballkanit, atëherë mjaftohen më këtë shfaqje të zymtë teatrale. Mendohet së paku të « shmanget më e keqja », përderisa autokratët ballkanikë vazhdojnë të vetëquhen « pro-evropian » dhe nuk gjuhen plotësisht në krahët e Kinës, Turqisë ose Rusisë. Më pëlqen analiza e Branko Millanoviçit i cili thotë se Mali i zi është ndoshta shteti i vetëm i rajonit që do të mund të anëtarësohej në Bashkimin Evropian në një të ardhme më të afërt. Mali i zi nuk është shtet i madh dhe është anëtar i NATO-së. Anëtarësimi i tij nuk do të kushtonte shtrenjtë dhe do të mundësonte t’ia kthente pak besueshmërinë perspektivës evropiane, për ta bërë së paku ende të besueshme...Por sigurisht se edhe kjo do të ishte vetëm një lojë. Fundja, edhe nëse Mali i zi do të anëtarësohej në BE më 2025 ose 2030, ç’do të ndryshonte kjo për vendin, për rajonin dhe për vetë Bashkimin Evropian? Jo shumë gjëra. Në realitet, çështje e rëndësishme është të kuptohet pse dhe si procesi i anëtarësimit ka humbur dimensionin e tij performativ, apo kapacitetin e tij për t’i ndryshuar institucionet dhe shoqëritë e vendeve ballkanike.

Florian Bieber :Kam frikë se procesi aktual do të vazhdojë të ngecë dhe se nuk do të ketë shumë lëvizje. Vetoja e parë franceze në vitin 2019 dhe vetoja bullgare vitin e kaluar dërgojnë një pamje të kthjellët dhe sugjerojnë që bllokimet e së ardhmes mund ta vonojnë zgjerimin për vite me radhë, edhe nëse vendet në rajon po bëjnë punën e tyre. Sidoqoftë, edhe në rajon ka progres të kufizuar dhe duket se reformat e nevojshme janë prioritetet e ulëta. Kështu që nuk shoh shumë shpresë pa një angazhim politik, përtej deklaratave që liderët e Bashkimit Evropian dhe ata të Ballkanit Perëndimor dëshirojnë të japin. Për më tepër, procesi duhet të reformohet. Kjo përfshin eliminimin e të drejtës së vetos për anëtarët individualë në të gjitha hapat e procesit të zgjerimit. Sigurisht që ka disa pika, si ratifikimi i traktatit të pranimit, të cilin të gjithë anëtarët duhet ta pranojnë, por pse për fillimin e bisedimeve? Së dyti, ekziston një nevojë për sundimin e ligjit dhe kushtëzimin e demokracisë brenda BE-së. Nëse Bashkimi Evropian mund të merret dhe merret me shkeljet në Hungari dhe në vendet e tjera, shumë anëtarë do të shqetësohen më pak për pranimin e vendeve të reja anëtare. Mbi të gjitha, ka mënyra për t’i adresuar shkeljet. Tani, pozicioni i Francës dhe të tjerëve ka qenë shumë përpjekje për t’i zgjidhur



të gjitha problemet e mundshme para anëtarësimit, gjë që është e pamundur. Asnjë vend nuk mund të jetë i sigurt nga shkeljet dhe nëse ndonjë vend duhet ta arrijë atë, ai nuk do të anëtarësohet kurrë. Në të njëjtën kohë, ekziston nevoja për një shtytje rajonale, idealisht nga baza kundër kapjes së shtetit dhe dominimit të partive autoritare.

Ballkani si terren eksperimentimi

– **Çfarë flasin për ju politikë e Viktor Orbanit, Janez Janshës, apo edhe të Bullgarisë ndaj Maqedonisë së Veriut, në kuptim të marrëdhënieve BE-Ballkan Perëndimor?**

Jean-Arnault Dérens : Natyra politike urren gjithnjë vakumin. Përderisa « qendra » e Bashkimit Evropian – kjo qendër e papërcaktueshme të cilën nuk arrijmë kurrë ta emërtojmë, duke mos qenë as Komisionin Evropian dhe as boshti Berlin/Paris – nuk kishte asgjë për t’i propozuar vendeve të Ballkanit kandidate për anëtarësim në BE; grupi i Vishegradit e mori përsipër plotësimin e këtij boshllëku, duke e propozuar vizionin e tij për Evropën, një Evropë etnike dhe të bardhë, të mbyllur në vetvete... Nuk them kurrë se Viktor Orban është « anti-evropian ». Kjo do të ishte e pasaktë. Ai është plotësisht pro-evropian, por ka një vizion për Evropën që nuk është i imi! Viktor Orban ka propozuar modelin e tij ksenofob, që i ka mundësuar të ndërtojë rrjete të rëndësishme

të ndikimit në tërë Ballkanin. Janez Jansha është një aktor i rëndësishëm i këtyre rrjeteve, por Kryeministri hungarez ka marrëdhënie shumë të mira edhe Presidentin e Serbisë Aleksandër Vuçiq! Në muajin korrik të vitit të kaluar, François-Xavier Bellamy, drejtuesi i së djathtës franceze në Parlamentin Evropian, bashkonte në një panel Viktor Orbánin, Aleksandër Vuçiqin dhe Janez Janshën për një zoom-konferencë publike me temën : « Europe uncensored » (Evropa pa censurë). Ata ishin ftuar të debatonin mbi kërcënimin kryesor që rëndon sipas tyre Evropën në këtë periudhë pandemie dhe krize ekonomike : « marksizmi kulturor » ! Pra, Ballkani shërben edhe si terren eksperimentimi të një konvergjence të re midis rrymave ksenofobe, nacionaliste dhe ultrakonservatore. Kryeministri bullgar Boiko Borisov është po ashtu një eksperimentues i rrezikshëm : shumë vite para Viktor Orban, ai ngriti një « muri » me tela kundër refugjatëve në kufijtë e shtetit të tij (përfshirë edhe në kufirin me Turqinë). Borisovi ishte po ashtu drejtuesi i parë i një partie anëtare e Partisë Popullore Evropiane që hynte në koalicion me të djathtën ekstreme. Kjo në vitin 2017 dhe të djathtët ekstrem bullgarë nuk janë aq të butë! Por, Boiko Borisov është më i kujdesshëm se Viktor Orban. Ai di të qëndrojë diskret dhe t’i shmanget provokimeve. Për më tepër, për arsye historike dhe gjeopolitike, ai tregon një besnikëri atlantike absolute përballë Rusisë, gjë që i jep atij një çek të bardhë për gjithçka tjetër, duke filluar nga

korupsioni sistematik të regjimit të tij e deri të provokimet ndaj Maqedonisë së Veriut.

“Sigurisht se shohim rikthimin e të ‘vjetërve’ nga administrata Clinton, të cilët e kanë ruajtur një lloj ‘ndjenje’ për Ballkanin, veçanërisht për Kosovën, por nuk jemi në kohëra të njëjta dhe prioritetet e Shteteve të Bashkuara nuk janë po ashtu të njëjta. Çështjet serioze vazhdojnë të diskutohen në Berlin” – Jean-Arnault Dérens “

Florian Bieber :Të tre burrat e fortë ndjekin politika të ndryshme, por asnjëri nuk është dashamirës. Orban mbështet zgjerimin, por është skeptik kryesisht për të njëjtën arsye si Franca dhe Holanda. Ai dëshiron më shumë Orbanë, dmth. udhëheqës të tipit Vuçiq dhe Gruevski, të cilët do ta mbështesnin atë dhe do ta forconin po ashtu një pamje më nacionaliste të Evropës. Jansha është bërë një aleat i kësaj pikëpamje. Borisovi është një lloj i ngjashëm sundimtari me dy të tjerët, por më pak ideologjik dhe më i kujdesshëm për të mos e sfiduar BE-në si të tillë. Ai shtiret kinse luan në bazë të librit evropian liberal, por vetoja e qeverisë së tij ndaj Maqedonisë së Veriut tregon gatishmërinë e tij për ta përdorur BE-në që ta shtyejë përpara një agjendë nacionaliste dhe për t’i ftuar luftërat e brendshme të pushtetit. Në të tre rastet, qeveritë e tyre nuk po sillen si miq të qytetarëve të Ballkanit Perëndimor, por përkundrazi mbështesin liderë autoritarë dhe nacionalistë. Në



JEAN-ARNAULT DÉRENS

këtë mënyrë, ata po e ndihmojnë ruajtjen e status-quosë.

– **Përgjatë administratës Trump është vërejtur një shpërputhje në qëndrime midis Brukselit/Berlinit dhe Washingtonit rreth Ballkanit Perëndimor. Çfarë prisni në këtë kuptim nga administrata Biden?**

Jean-Arnault Dérens : Në parim, pritet që Biden t'i kthehet një politike ndërkombëtare më « klasike », sidomos kur kemi të bëjmë me marrëdhëniet transatlantike. Por do të ishte krejtësisht iluzore të mendohet se administrata Biden do t'i kthehet politikave të Barack Obama ose Bill Clinton! Bota ka ndryshuar radikalisht dhe Shtetet e Bashkuara janë shumë më të “vogëla” se para dhjetëra vjetësh, apo së paku janë më të kthyer drejt vetes. Pasojat e pandemisë mbeten ende vështirë të llogaritshme, por sigurisht se Shtetet e Bashkuara të Joe Biden do të përqendrohen në problemet e tyre ekonomike dhe sociale, e se do të jenë më pak të angazhuar në sfidat ndërkombëtare. Sigurisht se shohim rikthimin e të “vjetërve” nga administrata Clinton, të cilët e kanë ruajtur një lloj « ndjenje » për Ballkanin, veçanërisht për Kosovën, por nuk jemi në kohëra të njëjta dhe prioritetet e Shteteve të Bashkuara nuk janë po ashtu të njëjta. Çështjet serioze vazhdojnë të diskutohen në Berlin.

“Administrata Biden me siguri do ta braktisë qasjen transaksionare të administratës Trump dhe ka shumë njerëz në administratë që e njohin mirë rajonin, kështu që Ballkani mund të jetë një vend ku testohet bashkëpunimi i ripërtërirë transatlantik” – Florian Bieber

Florian Bieber :Sigurisht se do të ketë shumë më tepër bashkëpunim transatlantik dhe koordinim më të ngushtë midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian. Pikëpyetja e vërtetë është nëse do të kemi “vetëm” një kthim në vitet e Obamës, që do të thotë se BE-ja udhëheq dhe SHBA-ja mbështet përpjekjet e BE-së dhe përdor fuqinë e saj rajonale për t'i zgjidhur krizat, apo nëse do ta kemi një angazhim të ri më serioz. Administrata Biden me siguri do ta braktisë qasjen transaksionare të administratës Trump dhe ka shumë njerëz në administratë që e njohin mirë rajonin, kështu që Ballkani mund të jetë një vend ku testohet bashkëpunimi i ripërtërirë transatlantik. Pikëpyetja është nëse BE-ja është gjithashtu e gatshme, edhe duke mos injoruar SHBA-në, por duke punuar së bashku. Unë pres tone më kritike nga Washingtoni

drejt Beogradit, në veçanti për thyerjet demokratike në Serbi, që duket se do të jenë në agjendë. Presioni për një dialog thelbësor do të rritet gjithashtu nëse Kosova zgjedh një qeveri të qëndrueshme. Në anën tjetër, leva perëndimore është më e ulët se para 4-5 vjetëve për shkak të një Kine më aktive, një Turqi më antagonist dhe aktorëve të tjerë.

– **Është thënë shpesh se kryeqendrat perëndimore kanë parapëlqyer “stabilokracinë” kundrejt “demokracisë” në Ballkanin Perëndimor. Mirëpo, edhe pas rënies nga pushteti të Millo Gjukanoviçit, e sidomos të Nikolla Gruevskit në Maqedoninë e Veriut, nuk është se po ndjehen ndryshime përmbajtësore demokratike, si brenda republikave të tyre, ashtu edhe në marrëdhëniet e tyre me fqinjët?**

Florian Bieber :Maqedonia e Veriut është bërë dukshëm më e hapur dhe demokratike. Shenjat në Mal të Zi tregojnë edhe drejtime pozitive, edhe negative. Duhet bërë dallimi midis sundimit të një udhëheqësi autoritar e partisë së tij dhe rrënjëve më të thella të kapjes së shtetit. Këto nuk ndryshojnë brenda natës dhe shpesh nevojiten vite, jo vetëm për t'i ndryshuar institucionet, por edhe mënyrën sesi sillen individët. Ekziston gjithashtu rreziku që partitë e reja në pushtet t'i përdorin strukturat e pushtetit dhe mjetet e qeverisë së mëparshme. Kështu që është një proces i vështirë. Kjo vështirësohet nga mjedisi ndërkombëtar i de-demokratizimit në vitet e fundit, nga SHBA-ja në Poloni dhe në Hungari. Në këtë kuptim, tendencat më të mëdha globale pasqyrohen në rajon. Nëse ka një ringjallje të demokracisë liberale, ajo do ta rrisë edhe presionin në rajon.

– **Një nga arsytet e “përkëdheljes” ndërkombëtare të pushtetit së Aleksandër Vuçiqit në Serbi është edhe përceptimi se ai mund të jetë lideri serb që do ta njeh pavarësinë e Kosovës. Përderisa kjo nuk po ndodhë, Serbia është sot pothuajse pa opozitë parlamentare dhe me demokraci të kontestuar. Si e komentoni?**

Jean-Arnault Dérens : Sigurisht se Kosova është aseti kryesor, madje edhe siguria e jetesës politike të Aleksandër Vuçiqit. Duhet të shprehet dhe të bindë sikurse vetëm ai është në gjendje ta pranonte një “kompromis” për Kosovën që do ta refuzonin kundërshtarët e tij politikë, por këtë kompromis nuk duhet ta bëjë kurrë... Çfarë karta do të kishte ende në dorë Vuçiqi ditën që do ta nënshkruante marrëveshjen për Kosovën? Pra nuk do të ketë asnjë marrëveshje të kënaqshme, asnjë evolucion të vërtetë, përderisa Vuçiqi është në pushtet.

“Çfarë karta do të kishte ende në dorë Vuçiqi ditën që do ta nënshkruante marrëveshjen vendimtare për Kosovën? Prandaj edhe nuk do të ketë asnjë marrëveshje të kënaqshme, asnjë evolucion të vërtetë, përderisa Vuçiqi është në pushtet” – Jean-Arnault Dérens

Florian Bieber :Aleksandër Vuçiqi ka qenë shumë i aftë ta paraqes veten si feneri që mund t'i jep zgjidhje çështjes së Kosovës. Me këtë e ka fituar një mbështetje të madhe perëndimore. Mbështetja e tij për marrëveshjen e Brukselit dukej se i jepte atij të drejtë, por kanë kaluar gati 8 vjet dhe Vuçiqi nuk ka dhënë asnjë indikacion se është vërtetë i gatshëm t'i zgjidhë marrëdhëniet me Kosovën. Në fakt, ai e ka bërë edhe më të vështirë duke inkurajuar zëra nacionalistë dhe ksenofob në Serbi. Sot, çështja e Kosovës është më e rëndësishme dhe niveli i gjuhës së urrejtjes antishqiptare është më i madh. Derisa vazhdon të dërgojë sinjale se është i gatshëm të bëjë kompromis në Perëndim, ekziston ende iluzioni se Vuçiqi mund të jetë tregtari i mundshëm. Qeveritë e paqëndrueshme të Kosovës ia kanë bërë atij më të lehtë, meqë sinqeriteti i tij nuk është testuar.

(Mos)marrëveshja e largët Kosovë-Serbi

– **Në raportin e tij të fundit, International Crisis Group (ICG) ka përmendur disa opsione të mundshme për zgjidhjen e kontestit midis Kosovës dhe Serbisë : njohja e pavarësisë së Kosovës nga Beogradi në shkëmbim të ndihmës financiare dhe të anëtarësimit të shpejtë të Serbisë në Bashkimin Evropian; autonomi për serbët në Kosovë dhe për shqiptarët në Serbi; apo ndryshime të kufijve nëpërmjet shkëmbimit të territoreve? Sa janë reale këto zgjidhje, apo jemi më shumë në fazën e status quo-së të « durimit strategjik » deri në momentin e palës « që lodhet e fundit »?**

Jean-Arnault Dérens : Siç e thash më sipër, Aleksandër Vuçiqi nuk e ka asnjë interes të nënshkruajë çfarëdo marrëveshje vendimtare për Kosovën, sidomos në këtë moment, ku do të mund pastaj të përballlet me një kundërshtar politik të papritur, siç është Kisha Ortodokse Serbe....Pra, nuk do të ndodhë asgjë. Të jemi të qartë, ky raport i International Crisis Groupi publikuar vetëm disa ditë pasi Joe Biden mori detyrën e Presidentit, kishte për qëllim vetëm t'ia dërgojë një porosi partnerëve evropianë të Shteteve të Bashkuara...Shkurt, të përkëdhelet Mirosllav Lajçak, që mund tash të qëndrojë i qetë. Por, ky raport nuk do të ketë asnjë pasojë praktike, meqë Kosova dhe Ballkani nuk do të jenë prioritet i administratës Biden dhe meqë Gjermania po hyn në një vit zgjedhor.

Florian Bieber :Ka një problem me opsionet. Askush nuk

mund t'i premtojë anëtarësim të shpejtë Serbisë në Bashkimin Evropian, që kërkon pëlqimin e 27 vendeve dhe që do t'i minonte standardet demokratike të BE-së. Serbia nuk mund të bashkohet me BE-në shpejt nën qeverinë e Vuçiqit. Një autonomi për serbët në Kosovë tashmë ekziston dhe një autonomi e stilit “Republika Srpska” nuk do t'i shërbente askujt. Pastaj, ndryshimet e kufijve janë të rrezikshëm së pari për serbët në Kosovë, ngase shumica prej tyre nuk jetojnë në zonat pranë Serbisë, por pastaj edhe për rajonin. Kështu që asnjë nga opsionet nuk duket realist dhe i dëshirueshëm. Status quo-ja është më e mirë, se zgjidhjet e tilla të nxituara. Mendoj se opsioni i parë është i pamundur pasi vendet kryesore anëtare të BE-së nuk do të jenë në favor të anëtarësimit të Serbisë me shpejtësi dhe nuk jam i sigurt se ky është një shpërblim i mjaftueshëm për Vuçiqin. Opsionet e tjera duken joreale nga perspektiva e një qeverie të udhëhequr nga Kurti. Të dy opsionet e tjera janë problematike.

– **Hashim Thaçi dhe Aleksandër Vuçiqi nuk përfunduan si dy liderë që do ta firmosin “paqen historike” midis Kosovës dhe Serbisë. Sa i besoni një marrëveshje të tillë në të ardhmen e afërt dhe a mendoni se kjo mund të arrihet me Albin Kurtin dhe Aleksandër Vuçiqin ose me opozitarët e tij të sotëm në Serbi?**

Jean-Arnault Dérens : Mendoj se Albin Kurti është shumë i vetëdijshëm për veprimin strategjik të Aleksandër Vuçiqit, i cili luan gjithnjë lojën se kinse po e kërkon një marrëveshje “historike” për Kosovën, por që nuk duhet ta gjejë kurrë dhe aq më pak ta përfundojë. Kështu që shpresoj se Albin Kurti nuk do ta humb kohën e tij në dialogje të padobishme. Besoj se prioriteti i vërtetë i tij duhet të jetë krejt tjetër: është ta fitojë besimin e serbëve dhe të minoriteteve të tjera në Kosovë. Nëse ka sukses në këtë ndërmarrje, ai do të mund t'i ndryshojë rrënjësisht kushtet e ekuacionit të Kosovës.

“Nuk mendoj se do të ketë një marrëveshje midis Aleksandër Vuçiqit dhe Albin Kurtit. Ky i fundit do të jetë shumë i fuqishëm brenda vendit për ta pranuar një marrëveshje si ajo që Vuçiqi përpigjej ta nxjerrte nga Hashim Thaçi” – Florian Bieber

Florian Bieber :Nuk mendoj se do të ketë një marrëveshje midis Aleksandër Vuçiqit dhe Albin Kurtit. Ky i fundit do të jetë shumë i fuqishëm brenda vendit për ta pranuar një marrëveshje si ajo që Vuçiqi përpigjej ta nxjerrte nga Hashim Thaçi. Në anën tjetër, Vuçiqi mund të jetojë me status quo-në. Rrethana e vetme në të cilën mund ta imagjinoja Vuçiqin duke bërë një marrëveshje është ajo ku ai do ta

shpëtonte veten për ta siguruar një mbështetje të fortë perëndimore, nëse nuk do të kishte ku të drejtohej në rast të ndonjë presioni të fortë të brendshëm. Nëse në Serbi ekziston një opozitë nacionaliste dhe nëse partitë reformuese opozitare vazhdojnë presionin, atëherë ekziston mundësia që Vuçiqi ta shqyrtojë njohjen e Kosovës si një mënyrë për ta bërë veten të domosdoshëm për Perëndimin, nëse paralelisht e siguron mbështetjen për vazhdimin e qeverisjes së tij jodemokratike.

– **Derisa në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të Kosovës pritet fitorja e Vetëvendosjes së Albin Kurtit, po mbetet mjaft e panjohur se çfarë do të prodhojë e nesërmja qeverisëse e tij. Çfarë prisni nga qeverisja e tij duke pasur parasysh profilin e sotëm ideologjik të tij që noton midis së majtës dhe nacionalizmit, si dhe të partisë së tij që ka prirje të mishërojë pothuajse të gjitha ideologjitë e mundshme?**

Florian Bieber :Unë pres që Albin Kurti do të qeverisë në mënyrë pragmatike, siç e ka sinjalizuar viteve të fundit. Me pozicione të forta majtiste ose nacionaliste, Kurti do ta humbte mbështetjen, si brenda vendit, ashtu edhe jashtë. Nëse Kurti ka një shumicë solide, ai e ka dorën e lirë për ta luftuar korrupsionin dhe për të ndërtuar institucione të pavarura. Nëse do të ketë ndonjë sukses me këtë, Kurti do të jetë mjaftueshëm popullor dhe nuk do të ketë nevojë për të tjerë. Sigurisht se do të jetë e rëndësishme një strategji e mirë për tejkalimin e izolimit të Kosovës, veçanërisht nëse dialogu me Serbinë nuk çon askund. Për të fituar levë, Kosova duhet të jetë negociatore e besueshme dhe të tregojë mungesën e përkushtimit nga Serbia. Rreziku kryesor për Vetëvendosjen, si për çdo parti tjetër e cila mund ta fitojë një shumicë të madhe mbetet prirja autoritare. Shpresoj që partia e Albin Kurtit do ta ruajë pluralizmin e saj të brendshëm dhe që nuk do të bjerë në grackën e përdorimit të mekanizmit të kapjes së shtetit për agjendën e saj. Nuk po them se do e bëjë, por me institucione të dobëta dhe me histori të keqe të partive që e përdorin shtetin për agjendën e tyre, rreziqet janë reale.

– **Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit perceptohet edhe si organizatë anti-establishment. Sado të ndyshme, edhe për nga konteksti, shumë shembuj të tillë, si edhe ato në rajon, si Syriza në Greqi, nuk janë treguar të suksesshëm pasi e kanë marrë pushtetin. Çfarë pritni në këtë kuptim nga qeveria e Albin Kurtit duke e marrë parasysh kontekstin e Kosovës?**

Jean-Arnault Dérens : Fitortja e mundshme e Vetëvendosjes ngjall shpresa të mëdha në Kosovë dhe në rajon. Duhet kuptuar se po çahet kudo



FLORIAN BIEBER

sistemi stabilokratik i vendosur në vitet 2000 dhe 2010. Sigurisht se shembulli më i mirë është ai i Malit të Zi, me humbjen e DPS të Milo Gjukanoviçit, por shikoni edhe Bosnje dhe Hercegovinën, ku SDA pësoi në zgjedhjet komunale përgjatë nëntorit të kaluar, e veçanërisht në Sarajevë. Aleksandër Vuçiqi dhe Edi Rama ndjehen ende të plotfuqishëm, por mendoj se radha e tyre do të vijë shumë më shpejtë sesa që po mendohet... Për më tepër, ka të ngjarë që pandemia do ta përshpejtojë frymën e ndryshimeve. Për arsye të thjeshta sociologjike, ngase jo pak të rinj të diasporës kanë mbetur të ngujuar në vendlindjet e tyre dhe po votojnë më shumë se zakonisht. Kundër regjimeve në pushtet, natyrisht. Ç'mund të bëjë Albin Kurti në momentin e marrjes së detyrës në pushtet? Situata do të jetë shumë e vështirë, kryesisht për shkak të kolapsit ekonomik të shkaktuar nga pandemia. Por mendoj se duhet bërë dallimin midis dy çështjeve. Ajo e çlirimit të shoqërive dhe aparateve shtetërore, si dhe ajo e rindërtimit të një modeli të ri shoqëror. Merrni shembullin e Malit të Zi, ku koalicioni i ri i qeveritar është veçanërisht heterogjen: megjithë dallimet e mëdha ideologjike midis partnerëve, ky koalicion po merrret me këtë punë çliruese. U shkarkuan për disa javë, shefi i policisë dhe shefi i shërbimeve sekrete, e Prokurorja e Përgjithshme dha dorëheqje... Mali i Zi ka qenë një shtet i privatizuar për 30 vjet, plotësisht në shërbim të Millo Gjukanoviçit dhe miqve të tij. Pra, ka shumë punë. Po kështu, unë pres nga Albin Kurti dhe Vetëvendosja që të fillojnë ta çlirojnë Kosovën nga pushtimi i rrjeteve politiko-mafioze që e kanë dominuar pasfidueshëm Kosovën që nga përfundimi i luftës, që ta depolitizojnë shërbimin publik dhe t'i japin drejtësisë frymë autonomiste... Kjo punë parësore është thelbësore, por nuk është e lehtë për t'u realizuar. Pastaj do të duhet ndërtuar diçka të re, por në një kontekst rajonal dhe evropian që do të jetë gjithashtu në ripërkufizim e sipër.

Florian Bieber :Shembuj të tjerë tregojnë sesa është e vështirë të shkëputesh nga kapja e ngulitur e shtetit. Kjo do të jetë sfidë për Vetëvendosjen. Është e lehtë të dëshpërosh. Nga ana tjetër, niveli është i ulët në Kosovë, duke e marrë parasysh keqeverisjen e koalicioneve të mëparshme. Do të jetë më e lehtë se për Syrizan, ngase Vetëvendosja është më

pak ideologjike dhe po vjen në pushtet jo në një moment krize të krahasueshme me krizën e Eurozonës që përfshiu Syrizen në pushtet. Syriza pati pak përzgjedhje të mundshme dhe kjo e kufizonte aftësinë e saj për ta ndryshuar dinamikën në vend. Pastaj, Syriza nuk pati mbështetje të jashtme. Kjo bëri që ajo të luftonte me trojkën dhe të humbte shumë energji në këto beteja. Në fund, Syriza ndoqi rrugën që socialistët e PASOK-ut kishin ndërmarrë dekada më parë. Në Kosovë, ka më pak politikë ideologjike në lojë. Kjo do ta bëjë punën më të lehtë për VV-në, pa harruar se ajo ka më shumë mbështetje ndërkombëtare se Syriza.

Bashkëpunimi rajonal si dalje nga periferia e dominuar

– **Marrëveshja e 4 shtatorit në Shtëpinë e Bardhë midis Kosovës dhe Serbisë shihej më shumë rezultat i politikave gjeostrategjike të administratës Trump. Si pritni të sillt administrata Biden me marrëveshjen e 4 shtatorit, e veçanërisht në raport me Rusinë, Kinën, BE dhe Turqinë, në Ballkanin Perëndimor?**

Jean-Arnault Dérens : Cilat janë pikat konkrete të marrëveshjes? Dëbimi i 'Huawei' nga Ballkani? Jemi larg kësaj... Transferimi i ambasadës serbe në Jerusalem? Mendoj – dhe shpresoj – që nuk do të ndodhë kurrë... Ç'kishte tjetër në këtë marrëveshje? E dini ju? Unë jo...

Florian Bieber :Marrëveshja ishte kryesisht ajër i nxehtë. Disa pika të marrëveshjes, si zyra e investimeve e SHBA ka të ngjarë që do të mbetet, apo edhe disa angazhime financiare të SHBA në rajon, gjë që nuk do të shkaktojë dëme. Duket po ashtu se do të mbijetojë marrëveshja me Izraelin. Por, pjesa tjetër është aq e përgjithshme, sa që mbetet e paqartë se ç'është më tepër kjo marrëveshje se një deklaratë zotimesh. Në rrethana më të mira, SHBA-ja do ta përdorë marrëveshjen për ta ndërtuar një angazhim ekonomik dhe që të mbetet aktive në dialog. Sidoqoftë, rruga e SHBA-ve duhet të bashkohet me përpjekjet e BE-së dhe të bëhet specifike. Vula e marrëveshjeve midis Serbisë dhe Kosovës ka qenë paqartësia, ku secila palë e interpretonte atë në mënyra të ndryshme. Kjo nuk ka ndihmuar në zgjidhjen e çështjeve të hapura. Kështu që nëse marrëveshja e 4 shtatorit nuk zhvillohet dhe pjesët e dobishme të saj nuk përkthehen në çështje konkrete, ajo do të jetë si shumë shkrime në letër të vdekura më parë.

– **Projekti i krijimit të një Mini-Schengeni ballkanik**

duket se do të mbështetet edhe nga administrata Biden. Si e shihni këtë projekt në veçanti dhe nismat rajonale në përgjithësi?

Jean-Arnault Dérens : Ideja e Mini-Shengenit nuk është e keqe në vetvete, edhe pse tingëllonte shumë si një lojë politike që përpiqeshin ta luanin Aleksandër Vuçiqi dhe Edi Rama. Për çfarë po flasim saktësisht? Një zëvendësim për integrimin evropian, siç e denoncon Presidenti maqedonas Pendarovski? Po, sigurisht. Por, kur integrimi evropian mbetet vetëm një lajthitje, një iluzion, natyrisht se duhet shpikur korniza të reja për bashkëpunimin rajonal. Nga ana tjetër, për çfarë do të shërbejë ky Mini-Shengen? Lëvizjen e lirë të mallrave dhe njerëzve? Por sa është sasia e shkëmbimeve midis Shqipërisë dhe Maqedonisë? Cili është realiteti i fluksit të njerëzve midis Serbisë dhe Shqipërisë? Jo shumë, natyrisht... Nevojiten mjetet të reja bashkëpunimi rajonal shumë më ambicioze, të afta për të marrë një dimension politik që do të ndikonin të dëgjohet një zë i përbashkët i Ballkanit në nivelin evropian. Vetëm në këtë mënyrë i gjithë rajoni mund të fillojë të dalë nga pozicioni i tij aktual i periferisë së dominuar.

Florian Bieber :Mini-Shengeni ose ndonjë bashkëpunim tjetër rajonal, veçanërisht nëse shpie në relativizimin e kufijve dhe në rritjen e tregtisë është i dobishëm dhe i mirë. Nuk ka dyshim që ai kërkon mbështetjen nga SHBA-ja dhe BE-ja. Sidoqoftë, unë jam skeptik se do të bëhet realitet. Së pari, mjetet për këtë kanë ekzistuar për më shumë se një dekadë dhe kam përshtypjen që udhëheqësve të rajonit iu pëlqejnë deklaratat e mëdha, por jo edhe puna e madhe për t'i zbatuar ato në praktikë. Kështu që do të doja të shihja veprime. BE-ja dhe SHBA-ja mund të ndihmojnë, por i mbetet liderëve rajonalë që t'i respektojnë zotimet e tyre. Sidoqoftë, Mini-Shengeni do të ketë vetëm përfitime ekonomike modestë, pasi që shumica e tregtisë nuk është rajonale, por me BE-në. Përveç kësaj, nëse një vend anëtarësohet në BE, ai duhet të largohet nga Mini-Shengeni, kështu që është i përkohshëm në rastin më të mirë. Së fundmi, duhet të jetë e qartë se kjo nuk mund ta zëvendësojë integrimin në BE, edhe si një projekt i integritetit ekonomik, por edhe si një projekt politik, pasi që i mungon qëllimi i përmirësimit të sundimit të ligjit dhe të demokracisë në rajon, të cilat mbeten dy pengesat më të mëdha. Me pak fjalë, nëse bëhet realitet, ai do të jetë i dobishëm në zbutjen e pasojave të vonësës së anëtarësimit në BE, por nuk është ndonjë alternativë.

EDITORIAL

Kush do do të jetë armiku i radhës?

NGA SERGE HALIMI



Kartolina e urimit të fundvitit e z.Anders Fogh Rasmussen nuk e priti Vitin e Ri. Ish-Sekretari i përgjithshëm i Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) e përmbloodhi kësisoj misionin që do të duhej ta realizonte sa më shpejt NATO, sapo që z.Donald Trump të largohet nga Shtëpia e Bardhë: « Më 2021, Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tyre do ta kenë një mundësi që paraqitet një herë në çdo gjeneratë. Atë të përmbysjes së tërheqjes globale të demokracive përballë autokracive si Rusia dhe Kina. Por, për këtë duhet të bashkohen demokracitë kryesore ». Diçka që kanë bërë shumë prej tyre një gjeneratë më parë, kur pushtuan Afganistanin dhe pastaj Irakun. Pra, koha është me sa duket t'i vërshulen kundërshtarëve më të fuqishëm...

Po nga cili me filluar? Meqenëse Washingtoni synon ta sigurojë “udhëheqjen” e kryqëzatës demokratike. “Amerika është kthyer, e gatshme për ta udhëhequr botën”, tha z.Joseph Biden më 24 nëntor 2020. Vendet satelite do të bënin mirë ta kuptonin se Shtetet e Bashkuara nuk pajtohen më për identitetin e kundërshtarit të tyre kryesor. Më pak se në gjeopolitikën globale, arsyet gjinden te përçarjet e tyre të brendshme.

Për demokratët, armiku është para së gjithash ai rus. Për katër vitet e fundit, udhëheqësit demokratë, si znj.Nancy Pelosi, kryetare e Dhomës së Përfaqësuesve, kanë përsëritur se “me Trump të gjitha rrugët shpiejnë te Putini”.

Republikanët përgjigjen me parullën : “Pekin Biden”. Për shkak se djali i dytë i Presidentit të ri, z.Hunter Biden, ka bërë biznes në Kinë dhe

se globalizimi që i mvishet demokratëve, ka shërbyer për interesa të Kinës.

Më 10 dhjetor, Sekretari i Shtetit Michael Pompeo u përpoq ta zgjeronte hendekun ekzistues midis dy vendeve. Duke e vënë në pah, pa buzëqeshur, shqetësimin e tij për privatësinë, Pompeo që ka qenë edhe drejtor i Agjencisë Qendrore të Inteligjencës (CIA), alarmoi botën: “[Presidenti kinez] Xi Jinping vëzhgon secilin prej nesh”. Pompeo kritikoi po ashtu 400.000 studentët kinezë që vijnë çdo vjet për të studiuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një pjesë e të cilëve akuzohen se kanë vjedhur sekrete industriale dhe shkencore nga universitetet amerikane ku “shumë prej tyre janë blerë nga Pekini”. Së fundi, Pompeo kritikoi edhe produktet e kompanisë Huawei, ku sipas tij çdo përdorues përfundon « në duart e aparatit kinez të sigurisë ».

Ky është refreni që republikanët do t'ia përsërisin z.Biden. Ky i fundit do të përgjigjet katër vjet me paranojën anti-ruse të ushqyer nga demokratët kundër z.Trump. Deti i Kinës, Taiwani, fati i Ujgurëve, Hong-Kongu: çdo pretekst do të përdoret për ta sfiduar vendosmërinë anti-kineze të administratës së re.

Z.Rasmussen tregoi së paku mprehtësi në një pikë: « Një varg aleatësh të shqetësuar e presin Presidentin e zgjedhur Joe Biden para derës së tij ». Por duke qëndruar në një aleancë të udhëhequr nga një fuqi mendërisht të tronditur, ata nuk do ta gjejnë shpejt pagën e tyre.

AKTIVIZMI QË I NDANË KLASAT E VARFËRA

Qorrsokaku i politikave identitare

Gjuha identitare që ka shpërthyer me rrjetet sociale dhe në kanalet e lajmeve streaming rrënjësohet në një histori të gjatë. Kjo gjuhë që i takonte dikur së djathtës, tani përshkon edhe fjalimet e aktivistëve dhe udhëheqësve politikë të të gjitha rrymeve. Fjala "racë" është shndërruar në një faktor buldozer që po shtyp edhe të tjerët.

NGA STÉPHANE BEAUD DHE GÉRARD NOIRIEL

Më 25 maj 2020 çështja racore u rishfaq papritmas në qendër të aktualitetit kur imazhet e vrasjes së George Floyd, të xhiruara nga një kalimtare me një telefon celular, u transmetuan pa ndërprerë në rrjete sociale dhe në kanalet e lajmeve streaming. Vrasja e këtij afrikano-amerikan nga një polic i bardhë i Minneapolis-it ndezi një valë emocionesh dhe protestash në gjithë botën. Një mori akterësh – aktivistë anti-racistë, gazetarë, politikanë, intelektualë, ekspertë, artistë, shkrimtarë, etj. – u përfshinë në Shtetet e Bashkuara dhe gjetkë, për ta dhënë mendimin e tyre mbi këtë krim dhe mbi kuptimin e tij politik.

Në Francë, në pesëmbëdhjetë vitet e fundit, denoncimi publik i krimeve raciste ose i fakteve që ngrisin dyshime për diskriminim racor, ka marrë rregullisht formën e “çështjeve racore” në media, të cilat janë pothuajse pafundësisht të vetëqëndrueshme. Pas peticionit të titulluar “Manifesti për një Republikë franceze anti-raciste dhe të dekolonizuar”, të nënshkruar nga pesëdhjetë e shtatë intelektualë dhe të shpërndarë nga portali ‘Mediapart’ më 3 korrik 2020, e përjavshmja ‘Marianne’ u përgjigj më 26 korrik 2020 duke botuar një « Apel kundër ‘racizmit’ të çështjes shoqërore », nënshkruar nga më shumë se tetëdhjetë personalitete dhe njëzet organizata.

Krahasimi i dy peticioneve tregon se si funksionon ajo që Pierre Bourdieu e quajti lojën e “verbërisë së kryqëzuar”. Kritikat e justifikuar ndaj dhunës raciste të disa policëve dhe ndaj “racizmit shtetëror” në kolonitë franceze deri në fund të luftës së Algjerisë bënë që nënshkruarit e peticionit të Mediapart të mbrojnë një projekt politik të fokusuar në çështjet racore dhe dekoloniale të cilat mbulojnë faktorët shoqërorë. Në anën tjetër, autorët e thirrjes, të botuar në ‘Marianne’, kujtojnë rolin kryesor të klasës shoqërore në pabarazitë që e prekin sot Francën. Por, lufta e tyre për identitet, e përmbledhur në sloganin: “Republika jonë laike dhe shoqërore, një mundësi për të gjithë!”, i nxit ata të pohojnë se “vendi ynë nuk e ka njohur kurrë segregacionin”, një pohim që nuk mund ta mbështesë asnjë historian, asnjë sociolog serioz. Këto përplasja identitare, ku secili kamp e mobilizon një trup të vogël intelektualësh, i vendosin në një pozitë të vështirë studiuesit që mbrojnë autonominë e punës së tyre.

Amerikanizimi i jetës publike

Ky ‘racizim’ i diskursit publik është shpërndarë gjërësisht nga revolucionin digjital që shpërtheu në vitet 2000. Zhvillimi i jashtëzakonshëm i industrisë së medias përfundoi atë që Jürgen Habermas e pati quajtur “kolonizimi i botës së jetuar”. Këto makina të mëdha për fabrikimin e informacionit furnizohen njëzet e katër orë në ditë nga një karburant që shfrytëzon depozitat emocionale që gjinden në secilin prej nesh dhe që na bëjnë të reagojmë menjëherë dhe instiktivisht përballë padrejtësive, poshtëtimeve dhe sulmeve. “Fakt-devijimi” i lajmeve politike, që lindi me shtypin masiv në fund të shekullit të XIX, tani ka arritur kulmin e tij, duke e

zëvendësuar gjithnjë e më shumë analizën e arsyetuar të problemeve shoqërore me denoncimin e fajtorëve dhe rehabilitimin e viktimave.

Kompanitë e globalizuara amerikane që zotërojnë rrjetet sociale e kanë përshpejtuar brutalisht këtë proces, sepse miliarda individë që kanë qasje në këto rrjete nuk janë më vetëm pranues pasiv të diskursit të fabrikuar nga media, por akterë që marrin pjesë në përhapjen e tyre dhe madje edhe në zhvillimin e tyre. Rrjetet sociale kanë krijuar kështu një hapësirë publike të ndërmjetme që shkon përtej komizës së shteteve kombëtare, duke kontribuar fuqimisht në amerikanizimin e polemikave publike, siç ilustron nga shpejtësia me të cilën importohen shprehjet siç janë color-blind (“i verbër ndaj ngjyrës [së lëkurës]”), “Black lives matter” (“Jeta e zezakëve vlenë »), cancel culture (« kultura e anulimit ») etj.

Meqenëse tani racizmi është një nga temat më të përshtatshme politike për t’i mobilizuar emocionet e qytetarëve, kuptohet që denoncimi i tij zë një vend gjithnjë e më të rëndësishëm në media. Konstatimi i këtij fakti nuk është – a duhet ta kujtojmë? – mohimi ose minimizimi i realitetit të problemit. Në asnjë mënyrë nuk e përjashton konstatimin se në të njëjtën kohë po shtohen në media shprehjet e formave të papërmbajtura të racizmit. Qytetarët nga emigracioni postkolonial (vendet e Magrebit dhe Afrikës nën-Sahariene) – shumica e të cilëve i përkasin klasës punëtore – ishin viktimat e para të efekteve të krizës ekonomike në vitet 1980. Ata i janë nënshtruar formave të shumta të segregacionit, qoftë në qasjen në banim, punësim apo edhe në marrëdhëniet e tyre me zyrtarët shtetërorë (kontrollat e identitetit “bazuar në tiparet e fytyrës” nga policia). Për më tepër, këtyre gjeneratave shoqërore u është dashur të përballen politikisht me shembjen e shpësive kolektive të mbartura në shekullin XX nga lëvizja e punëtorëve dhe asaj komuniste.

Duke pasur parasysh rëndësinë e polemikave identitare në debatin publik, nuk është për t’u habitur që disa nga këta të rinj mund ta shprehin refuzimin e tyre ndaj një shoqërie që nuk u bën vend atyre duke i privilegjuar elementet vetanake të identitetit fetar, personal, të origjinës ose racës (të përcaktuar nga ngjyra e lëkurës). Fatkeqësisht, në mesin e tyre, më të varfrit privohen, për arsye socio-ekonomike, nga burimet që do t’u mundësonin atyre të diversifikonin aderimet dhe përkatësitë e tyre. Kjo e shpjegon faktin që ata e paraqesin botën shoqërore në mënyrë binare dhe bazuar në etni: “ne” (qytetarët, të rinjtë zezakë ose arabë, të përjashtuarit, por edhe gjithnjë e më shumë, si duket, “ne, myslimanët”) kundërt “atyre” (borgjezët, “galët”, njerëzit e bardhë, ose ateistët, etj.). Nëse duam ta shtyjmë luftën kundër racizmit deri në fund, duhet gjithashtu ta luftojmë këtë mbyllje identitare, sepse ajo i ndalon këta të rinj rebelë të kuptojnë se ekzistenca e tyre shoqërore përcaktohet thellësisht nga përkatësia e tyre në klasat e varfëra.

Gjuha racizuese që e paraqet ngjyrën



e lëkurës si variabël që i përcakton të gjitha praktikatat ekonomike, sociale dhe kulturore të bashkëqytetarëve tanë po shkatërron kompleksitetin dhe finesën e marrëdhënieve shoqërore dhe raporteve të pushtetit. Të gjitha sondazhet sociologjike, statistikore ose etnografike tregojnë megjithatë që variablat shoqërore dhe etnike veprojnë gjithnjë në bashkërendim dhe me intensitete të ndryshme. Nëse i gjithë arti i shkencave shoqërore konsiston në zbërthimin e imët, sipas konteksteve (gjeografike, historike, ndërvepruese), të variablave vepruese, mbetet fakti që ne nuk mund të kuptojmë asgjë në botën në të cilën jetojmë, nëse harrojmë që klasa shoqërore e përkatësisë (e matur sipas vëllimit të kapitalit ekonomik dhe kapitalit kulturor) mbetet, çfarëdo që të thuhet, faktori përcaktues rreth të cilit janë të përfuara dimensionet e tjera të identitetit të njerëzve.

Dëshmia më e mirë vjen nga ata që kanë përfituar nga lëvizshmëria sociale e cila u ka mundësuar atyre të kenë qasje në klasat e mesme (arsimtarë, edukatorë, punonjës socialë, punëtorë në botën e spektaklit, etj.), madje edhe në klasat e larta (gazetarë të televizionit ose radio, shkrimtarë, yje të këngës ose filmit, etj.). Pothuajse të gjithë këta “dezertorë të klasave”, siç i quajmë, përfitojnë nga burimet që u ofron ngritja e tyre shoqërore për t’i diversifikuar lidhjet e tyre emocionale, profesionale ose kulturore, sepse ata e dinë shumë mirë se kjo është një rrugë drejt më shumë liri. Pse duhet që pasardhësit e imigracioneve postkoloniale të cilët janë ende pjesë e klasave punëtore të kthehen vazhdimisht në statusin e tyre të viktimës dhe të privohen nga mjetet që u mundësojnë edhe atyre të kenë këtë emancipim?

Meqë nuk i paraqesin raportet e forcës që strukturojnë shoqëritë tona, këto diskurse identitare kontribuojnë në thellimin e ndarjeve brenda klasave punëtore: ky ka qenë qëllimi i forcave konservatore nga vitet 1980 për ta thyer hegjemoninë e së

majtës. Të vendosësh luftën politike në nivelin racor duke i paraqitur të gjithë “të bardhët” si të privilegjuar, do të thotë t’i nxitësh ata ta mbrojnë veten me të njëjtin lloj argumentesh. Meqenëse në Francë “të bardhët” janë shumicë, “jo të bardhët” janë të dënuar të qëndrojnë përgjithmonë pakicë. Të besosh se aktet e shtrëngimit të stilit Jeff Bezos mund të bëjnë që individët e definuar si “të bardhë” të heqin dorë nga “privilegjet” e tyre do të thotë ta reduktosh politikën në mësim moralizues; gjë që është e zakonshme në Shtetet e Bashkuara dhe kjo ka tendencë të bëhet e tillë edhe në Francë.

Meqenëse tani përvoja amerikane mobilizohet vazhdimisht kur hapet tema e çështjes racore, vlen ta kujtojmë analizën e paraqitur së fundmi nga filozofi Michael Walzer për ta shpjeguar dështimin relativ të lëvizjes anti-raciste të afro-amerikanëve, një dështim i cili nga ana tjetër shpjegon pse racizmi mbetet një problem qendror në Shtetet e Bashkuara. Në fillim të viteve 1960, ai ishte një student plotësisht i përkushtuar në luftën për të drejtat civile të udhëhequr nga amerikanët zezakë. Pesëdhjetë vjet më vonë, ai i kthehet këtij momenti kyç të angazhimit të tij politik. Na kujton forcën e lidhjeve të krijuara në Jug, midis studentëve të universiteteve të mëdha të Veri-Lindjes (Harvard, Brandeis), në veçanti studentëve hebrej si ai dhe pastorëve e aktivistëve të zinj.

Kur e bën bilancin pas kësaj periudhe, ai ngre pyetjen thelbësore të aleancave politike që duhet bërë në kampin e forcave progresive: “Ne mendonim se nacionalizmi i zi, ndonëse ishte i kuptueshëm, ishte një gabim politik: nëse dëshirojnë të dëgjohen, pakicat duhet të angazhohen në politika të koalicionit. Hebrejntë e kanë mësuar këtë shumë kohë më parë. Ju nuk mund të izoloheni kur përfaqësoni 10 ose 20% të popullsisë. Keni nevojë për aleatë dhe duhet të zhvilloni politika që promovojnë aleanca. Nacionalizmi i zi e refuzoi këtë dhe kjo e çoi atë në qorrsokak

(...). “Politikat identitare” u avansuan në politikën amerikane dhe çuan në lëvizje të ndara: zezakët, hispanikët, gratë, homoseksualët. Nuk kishte solidaritet midis këtyre formave të ndryshme të luftës për njohje. “Black lives matter”, për shembull, është një shprehje themelore e zemërimit legjitim të zezakëve, e lidhur veçanërisht me sjelljen e policisë. Por, spanjollët nuk trajtohen më mirë. Nuk ekziston “Hispanic lives matter”, me sa di unë, dhe asnjë përpjekje të koordinuar për ta krijuar një koalicion të grupeve etnike për reformën e policisë”.

Duke pasur parasysh amerikanizimin e jetës sonë publike, fatkeqësisht mund të kemi frikë se konstatimi i Walzer po konfirmohet edhe në Francë. Sigurisht, shumë zëra dëgjohen, duke u lutur rregullisht për “konvergencën e betejave”. Sidoqoftë, ata që militojnë në këtë drejtim tani duhet të veprojnë brenda sistemit të ri të komunikimit që u imponua me revolucionin digjital të viteve 2000. Më parë, për ta promovuar një kauzë në hapësirën publike, duhej që kjo kauzë të ishte e përcaktuar dhe e mbrojtur kolektivisht nga organizata që bashkonin një numër të madh aktivistësh. Sot mjafton që disa aktivistë – të cilët flasin si zëdhënës të ndonjë pretendimi pa qenë emëruar nga askush – të tërheqin vëmendjen e medias. Prandaj përhapja e veprimeve spektakolare, sikurse ato të aktivistëve që ndalojnë shfaqjet në emër të luftës anti-raciste. Gatisshmëria e gazetarëve ndaj këtij lloji të veprimit nxit polemikat që ndajnë vazhdimisht forcat progresive. Derisa liria e shprehjes dhe anti-racizmi ishin shoqëruar gjithmonë deri më tani nga e majta, këto grupe ultraminoritare i përballen kundër njëri-tjetrit. Kjo i hapë një rrugë të rëndësishme konservatorëve.

EDITORIAL

Për një parti të re të majtë

Qasja që na ofron Partia Socialiste sot si e vetmja parti e denjë për emrin, është “martesa” e interesave të biznesmenëve me atë të klasës së mesme dhe kjo ka rezultuar një punë e pamundur, duke e futur Shqipërinë prej 30 vjetësh në një krizë politike, por të mos kemi asnjë iluzion, kriza e politikës është kriza e të majtës ose më saktë e mungesës të së majtës në Shqipëri.

NGA LEART KOLA*

E vetmja gjë, që mund të mësojmë nga historia është se nuk mësojmë asgjë nga historia’- Hegel (‘The only thing that we can learn from history is that we learn nothing from history).

Gurët, që hidheshin lumë mbi policinë në ditën pas vrasjes së Klodianit në lagjen periferike të Laprakës, ishin të njëjtët me ato që hidheshin më 21 janar, apo dhe me ato që fluturonin mbi kokat e sampistëve të Ramiz Alisë në fillim të 90-ës e të Sali Berishës më pas. E vetmja gjë, që ndryshonte ishin duart, por mbase dhe ato ishin të njëjta, në mos si njerëz si gjenerata. Asgjë nuk ndryshon jo vetëm për ata, që të rritur në frustrimin e një politike ineficiente e kanë transmetuar mllëfin brez pas brezi, por dhe ata që mbetën të njëjtët, që për dekada të tëra tashmë mësuan ti transferojnë njëri-tjetrit pushtetin me synimin që asgjë të mos ndryshojë, që gjithçka të mbetet e paprekur jo vetëm në kuptimin e kapitalit, por mbi të gjitha të mos ndryshojë ideja që nëpërmjet procesit politik gjërat mund të përmirësohen. Duke e ofruar veten si “fundin e historisë”, Shqipëria po futet në vitin zgjedhor më depresiv, që ka parë ndonjëherë, që pas rrëzimit të komunizmit. Të gjithë partitë e listuara, por sidomos dy kryesoret janë aq të ngjashme me njëra-tjetrën sa tashmë dhe aktivitetet janë njësoj. Atë, që bën Lulzim Basha tani e bënte Edi Rama dje, e atë që do bëj Edi Rama nesër (përuime/ investime/ rrugë të reja) e bënte Sali Berisha pardje. Në dy fushatat e fundit këto parti nuk bëjnë as “sikur” kanë një program, gjithçka që duhet të zgjedhin/ zgjedhim mbështet mbi parimin: cili është burri/ gruaja më i mirë, nën terrorin e zgjedhjes së keqes më të vogël.

Asgjë e mirë nuk vjen nga zgjedhja e të keqes dhe kur ajo është më e vogël duhet një alternativë tjetër, që merr parasysh jo vetëm kushtet sociale dhe historike në të cilat gjendet Shqipëria, por mbi të gjitha vetë kërkesën e shqiptarëve, që në këto vite ka qenë më e shprehur, më e organizuar dhe më e zhurmshme se kurrë më parë. Kant thotë: “bindu, por mendo, ruaj gjithmonë lirinë e mendimit”, për këtë liri jemi duke folur sot, lirinë e mendimit që prodhon alternativën më të mirë si mundësi politike dhe jo zgjedhjen më të keqe si pamundësi historike.

‘ Mund të kemi ardhur me anije të ndryshme, por tani jemi të gjithë në të njëjtën varkë.’

(‘We may have all come in different ships but we are in the same boat now.’)

Ti nuk qubesh socialist sepse mund të jesh anëtar në një parti, që quhet Parti Socialiste dhe nuk mund të konsiderohesh si i majtë vetëm sepse shanë partitë, që janë të djathta. Duhet patjetër dhe të tregosh së çfarë duhet të bëj një parti e majtë!

Në fjalët ekzakte të Tony Benn: “You cannot go on forever saying that you are a Socialist when you are not saying you will do something when you want confining yourselves to attacks on the Tories when it’s simply not enough. People want to know what the Labour Party will do”.

Tentativa e brishtë e programit të 2013-ës,

i cili synonte jo vetëm zhvendosjen e Partisë Socialiste në qendrën e majtë, por dhe nisjen e një komunikimi të ri institucional mes shqiptarëve dhe shtetit të tyre në pak kohë, por sidomos në mandatin e dytë, u zëvendësua nga sjelljet bizarre të një kryeministri të marrë peng nga nevoja narciste për t’u pëlqyer ai vetë dhe jo qeveria apo shteti, të cilin ai drejton. Në këto kushte dhe për pasojë të zgjedhjeve ekstreme neo-liberale si PPP-të e famshme, ne kaluam nga fillimi i mandatit të parë ku personazhi më i famshëm i qeverisë ishte Ministri i Mirëqenies Sociale tek fundi i mandatit të dytë, ku më i famshmi është Drejtori i Përgjithshëm i Policisë. Kurba është interesante sepse vërteton atë, që kemi mësuar nga aplikimi i normave neo-liberale në ekonomi, sidomos në vendet e Amerikës Latine, nëse aplikon një sistem agresiv pro-biznesit atëherë shteti transformohet në mbrojtësin e interesave të biznesit nëpërmjet aparatit të tij të dhunës, thënë ndryshe policisë. Simboli tipik për këtë dhe vizualisht është mbrojtja, që organizoi policia për kioskat e Kastratit në Kukës.

E paqendrueshme është e pakta, që mund të thuhet për këtë rrugë ekonomike, që ka ndërmarrë shteti shqiptar nëpërmjet Partneritetit Publik Privat, që historia na tregon që me një shpejtësi marramendëse kthehet në një vasalitet të shtetit karshi privatit dhe ç’është më e keqja në një stabilizant të korrupsionit sistematik, duke prodhuar kështu një kastë të vogël milionerësh, që kujdesen për “mirëqenien” ekonomike të partive dhe politikanëve, që e mbështesin në kurriz të shumicës popullore. Antonio Gramsci thotë: “një shkretëtirë me një grup palmash të larta mbetet sërisht një shkretëtirë, madje karakteristike e shkretëtirës është, që të ketë një grup palmash të larta”. Ne jetojmë në shkretëtirën ekonomike të prodhuar nga zgjedhjet e gabuara, por mbi të gjitha në një shkretëtirë alternativash politike.

Ka një të përbashkët shumë të rëndësishme mes protestës së studentëve, asaj të naftëtarëve dhe revoltës së periferisë dhe kjo e përbashkët nuk është plotësisht ekonomike, por ka të bëjë me një gjë akoma dhe më problematike; ka të bëjë me establishmentin aktual politik. Është imagjinata, që gjërat mund të bëhen më mirë. Kjo mungon dhe ketë nuk e garantojnë dot as këta, që janë as ata që duan të vijnë.

Së pari, të analizojmë aspektin ekonomik, a e mbani mend pse nisi protesta e studentëve? Sepse studimet në universitetin publik janë të shtrenjta, sepse familjet nuk i kanë ato para dhe sepse tregu i punës nuk u mundëson të rinjve të punojnë për të paguar studimet. Janë pra në kurth. Studenti i varfër është në kurth, por nuk ndodhi vetëm kjo, por ndodhi vetëdijësimi, solidariteti dhe i atyre, që mbase se kishin problem me ata, që e kishin problem, por si e zgjidhi qeveria këtë gjë? Duke ndryshuar ministrin (që ska lidhje) dhe duke hapur një tender me PPP për të rikonstruktuar ndërtesat. Pra nuk u adresua në asnjë nivel, në asnjë formë jo vetëm pamundësia ekonomike, që krijoi protestën por mbi të gjitha pamundësia organike, që ka universiteti në Shqipëri për t’i krijuar studentit një imagjinatë, që ajo që po bën është diçka, që do ti shërbejë atij dhe shoqërisë. Asgjë pra nuk u bë. Ajo protestë është në pritje dhe do kthehet dhe më e madhe se më



parë, sepse nuk kanë rrugë tjetër.

Zgjidhja me naftëtarët tingëllon e njëjtë me atë të studentëve, të mbajtur në një strukturë komplet ineficiente nga ana ekonomike, të përdorur si mish për top votash. Naftëtarët nuk duan të dëgjojnë më arsyetimet në dukje të sinqerta të qeverisë, ‘simbol i kapitalizmit shqiptar’, rafineria e naftës ngërthen brenda vetes gjithë historikun e abuzimit të punonjësit publik nga kompani private e korrupsioni endemic. Pra nëse do donim në të ardhmen, që studiuesit të analizojnë kapitalizmin alla shqiptarçe atëherë do mjaftonte të “rekuperonin kutinë e zezë të rafinerisë së naftës”. Qeveria atyre qindra naftëtarëve të hedhur rrugëve i dha 1 vit rrogë! Po çfarë do ndodhi pas 1 viti? Si mendon Edi Rama, që do i thotë njerëzve, që nuk kanë bukë të hanë, që unë jam më i mirë se Salii, sepse ju dhashë një vit rrogë? Po dhe nëse kjo është e vërtetë, që ai është më i mirë se Salii, çfarë ndryshon në thelb në jetën e tyre? Ashtu si me studentët thjesht është marrë borxh kohë nga e ardhmja, për ta bërë plagën shoqërore dhe më të thellë dhe më të pashërueshme.

Ashtu siç kapitalizmi i bankave merr borxh nga e ardhmja para, për të paguar detyrimet e sotme, ashtu dhe qeveria merr borxh kohë nga e ardhmja për të shtyrë me sa të mundet krizën e pashmangshme.

‘Varfëria lind dëshirën për ndryshim, dëshirën për veprim dhe dëshirën për revolucion.’

(‘Poverty gives rise to the desire for change the desire for action and the desire for revolution.’)

Në këtë kuadër, testimet e ndryshme shoqërore janë bërë, niset me protestën e studentëve, vazhdohej me atë të naftëtarëve deri sa të plas në dorë, bomba, dhe pse pasojë e një incidenti me revoltën e periferisë. Të gjitha këto protesta dhe pse të ndryshme në natyrën e tyre, kanë vetëm një të përbashkët, diferencat sociale dhe ekonomike, thellimin e varfërisë.

Ndërtimi i një alternative sociale dhe socialiste, pra jo vetëm si strukturë politike, por dhe si mënyrë e mendimit të shtetit, është e vetmja shpresë që ka Shqipëria për të dalë nga kjo situatë. Nuk duhet vetëm

një parti alternative, por mbi të gjitha duhet një kulturë shoqërore alternative që zgjidhjen e gjen tek angazhimi kolektiv dhe nuk ja delegon pakicës së politikës dhe biznesit mirëqenien shoqërore. Socializmi thotë Bernstein kur huazon nga Kant “është teori që në aspektin moral dhe etik duhet bërë, por kjo nuk e bën atë automatikisht të destinuar për të qenë... për këtë duhet një emancipim shoqëror dhe mbi të gjitha një angazhim politik, për atë që duam të jetë e jo për të zgjedhur midis atyre që na ofrohen si alternativat në fundme”.

Protestat, janë një formë e rendësishme për ta bërë zërin të dëgjohej, por shpeshherë krijojnë ndjesinë e Sizifit, që pasi e ka ngritur gurin në majë, do duhet ta shohë atë të rrotullohet poshtë, a nuk pati protesta studentore një fat të tillë? Ndaj kur luftojmë politikisht duhet të luftojmë për një “universitet tjetër” e jo vetëm për uljen e tarifave. Në momentin, që futemi në negociatë me sistemin në atë moment preçiz ai (sistemi) ka fituar. Me fjalë të tjera gjithçka, që fitohet është një pezullim i përkohshëm i represionit në vend të zëvendësimit të institucionit abuziv, që është thelbi i problemit.

Megjithatë kemi mësuar, që revolucionin nuk ndodh vetvetiu dhe shumica nuk rrisin gjithçka për ta arritur atë. Për këtë nuk mund të varem në angazhimin e shumicës, por në një pakicë të disiplinuar energjike dhe mbi të gjitha e vetëdijshme për momentin dhe rolin historik që ajo ka. Këtu duhet të fokusohemi. Prandaj ne sot kemi nevojë për një parti të re të majtë, ose me saktë për një diskutim jashtë parametrave të media/portaleve dhe shoqërisë së spektaklit, një diskutim horizontal, që do mund të ngjizte një subjekt politik si alternativë politike ndaj asgjësë, që ekziston sot në vend.

Qasja që na ofron PS sot si e vetmja parti e denjë për emrin, është “martesa” e interesave të biznesmenëve me atë të klasës së mesme dhe kjo ka rezultuar një punë e pamundur, duke e futur Shqipërinë prej 30 vjetësh në një krizë politike, por të mos kemi asnjë iluzion, kriza e politikës është kriza e të majtës ose më saktë e mungesës të së majtës në Shqipëri. Ndërkohë, që populli sa herë e ka sjellë të majtën në pushtet si në 97-ën po ashtu dhe në 2013-ën ka bërë hapa të mëdha progresist përpara, ka këputur zinxhirët e

interesit jo vetëm duke avancuar si militant partie por si shoqëri e tërë (kujtoni përmasat historike të votimeve si në 97-ën po ashtu në 2013-ën). E majta përpara zhvillimit ka preferuar gjithmonë stabilitetin, duke prodhuar kështu regresin, kështu ndodhi në 2005-ën e mos çuditëmi kur të ndodhë e njëjta gjë dhe pas disa muajve. Por a duhet ne të rrimë të presim, që kjo të ndodhë sërisht?

Ndërtimi i një alternative socialiste është jo vetëm shpëtim shoqëror përpara problemeve të pa zgjidhura të shumicës së popullsisë por është dhe një mundësi për të ndërtuar një Shqipëri më të mire. Partitë ekzistente nuk kanë idetë as mundësitë për të zgjidhur krizën, në të cilën është zhytur Shqipëria, për pasojë bie si këmbanë shprehja e Walter Benjamin që “pas çdo fashizmi fshihet një revolucion i dështuar”. Nëse kjo frymë e protestës nuk do materializohet për të transformuar shoqërinë dhe institucionet tona politike dhe administrative në një strukturë solidariteti, atëherë askush mos çuditet kur ato të kthehen në një strukturë ushtarake, të ndonjë hibridi nacionalist me mbështetje biznesi.

Në këto kushte beteja e 25 prillit është një betejë e kotë, ajo që do ndodhë pas saj është beteja e vërtetë, kushdo qoftë fituesi nuk do mund të ketë një jetë të gjatë me këto problem, që përballat vendi.

Marx thotë: ‘njerëzimi e krijon vet historinë, por nuk e bën atë si ti doje qefi: nuk e bën atë në rrethana të vetë-zgjedhura, por në rrethana ekzistuese tashmë, në të dhëna dhe transmetuara nga e kaluara.’

(“men make their own history, but they do not make it as they please: they do not make it under self-selected circumstances but under circumstances existing already, given and transmitted from the past”.)

Në këto kushte ne nuk mund të fajsojmë të shkuarën për të tashmen tonë, sepse nuk është detyra e prindërve të zgjidhin problemet e fëmijëve, kjo është një detyrë historike e si thuhet: men should make his own history. (Njeriu duhet të krijojë vet historinë e tij.)

*Autori është drejtor i Institutit të Studimeve Sociale dhe Humane në Tiranë

KUR CITY OF LONDON MILITONTE PËR BREXIT

Epoka e financave autoritare

"Çmenduri", "gabim", "lëvizje pokeri" ... Që nga referendumi i vitit 2016, Brexit është paraqitur shpeshherë si rezultat i një kombinimi fatkeq të rrethanave. Megjithatë, ai i përgjigjet në mënyrë të përkryer, pritjeve të një pjese në rritje të sektorit të financave, që ndjehet ende shumë i kufizuar nga rregulloret evropiane.

NGA MARLÈNE BENQUET DHE THÉO BOURGERON*

Në mëngjesin e 24 qershorit 2016, bota zbuloi se në pyetjen: “A duhet që Mbretëria e Bashkuar të mbetet anëtare e Bashkimit Evropian apo të del prej saj?” 51.9% e votuesve u përgjigjën: « leave » (dalje). Për shumë, ky rezultat ishte një befasi: City i fuqishëm, i përkëdheluri nga të gjitha pushtetet në Londër, dukej i bashkuar në favor të “remain” (qëndrim). Ç’ndodhi? A nuk kishin mjete të mjaftueshme punëdhënësit më të fuqishëm financiarë në Evropë që të dëgjohesh zëri i tyre në një çështje që ndikonte në të ardhmen e tyre?

E zhurmshme, fushata e udhëhequr nga City në favor të “Remain” maskoi megjithatë një fushatë tjetër, më diskrete, por gjithsesi masive. Në të dhënat e bëra publike nga komisioni zgjedhor britanik gjejmë elemente të cilat shpjegojnë në tri përfundime. Së pari, pothuajse dy të tretat e sektorit financiar investuan në referendum për ta mbështetur fushatën “Leave”, ndërsa nga ana e tyre, sektorët industrial investuan pothuajse gjysmën e kapitalit të tyre. Pastaj, 57% e të ardhurave për fushatën “Leave” buruan nga sektori financiar, krahasuar me vetëm 36% për fushatën “Remain”, gjë që tregon se fushata më “e financuar” nga të dyjat nuk është ajo që mendojmë. Në fund, dy grupet e akterëve financiarë adoptuan qëndrime të ndryshme.

Nga njëra anë, i kemi përfaqësuesit e “sektorit të parë të financimit”: bankat, kompanitë e sigurimeve, kompanitë e konsulencave, të komunikimit dhe informacionit financiar, të ndërmjetësimeve, të këmbimeve, të investimeve institucionale (përfshirë fondet e pensionit). Mënyra e mbledhjes së fondeve të kësaj kategorije karakterizohet nga një ofertë publike për kurse, e cila investohet për një periudhë të shkurtër në aksione të blera në tregjet aksionare. Kjo mënyrë e pasurimit nuk nënkupton kontrollimin e ndërmarrjeve nga pronarët financiarë të letrave me vlerë: këta të fundit kryesisht veprojnë në mënyrë pasive, e delegojnë kontrollin e kompanive tek menaxherët.

Nga ana tjetër, i kemi përfaqësuesit e “sektorit të dytë të financimit”: sektorët e menaxhimit alternativ të aseteve, të investimeve në kapital dhe të fondeve mbrojtëse. Këta bëjnë thirrje për investime private për një periudhë mesatare në asete jashtë tregut, të cilat i kontrollojnë. Metoda e tyre e menaxhimit është alternative, do të thotë se është relativisht e ndarë nga tregjet financiare, ose që investimet e tyre janë të palistuara, ose që u përgjigjen vetëm sektorëve shumë të rrezikshëm të tregjeve aksionare.

Të dhënat e financimit të dy fushatave tregojnë një situatë të qartë: fushata në favor të “Remain” u financua kryesisht nga akterët e parë, ndërsa fushata në favor të “Leave” nga ata të dytë (deri në 94% të shumës totale).

Megjithëse rregulloret evropiane shpesh janë përshkruar nga studiuesit kritikë si një formë e ‘kushtetutëzimit’ të neoliberalizmit, si një ndërmarrje për të konfiskuar sovranitetin e popujve në favor të interesave financiare, që do të thotë një operacion shumë i mirë institucional për

sektorët financiarë evropianë, ato akoma nuk janë mjaft të përshtatshme për akterët e financimit të dytë. Duke braktisur Bashkimin Evropian, ata shpresojnë të jenë të lirë të investojnë siç e gjykojnë të arsyeshme, pa mbikëqyrjen e Brukselit, të cilin e vlerësojnë si shumë kufizues.

Më 14 maj 2016, ekonomisti Savvas Savouri i fondit ‘Toscalfund Asset Management’ pohoi në gazetën ‘Le Monde’ se ai ishte ‘ngopur me retorikën anti-Brexit’ të përhapur në fushatën e referendumit. « Të gjitha këto kërcënime më duken të pakuptimta, vazhdon ai. Ne kemi gjysmë miliard paund të investuara në patundshmëri dhe biznese në Mbretërinë e Bashkuar. Sikur të shqetësoheshim për pasojat ekonomike të largimit nga Britania, do ta thonim. Përkundrazi, kjo do të jetë një mundësi e artë për rritjen e vendit ». Sipas tij, rreziku kryesor financiar afatgjatë nuk është largimi nga Bashkimi, por bllokimi brenda tij. Z.Roger Bootle, themelues i ‘Capital Economics’, një zyrë private për konsulencë makroekonomike dhe kolumnist i përjavshëm për Daily Telegraph, ndanë këtë analizë: « Largimi nga Bashkimi do të thotë hapje ndaj botës. Shikoni performancën katastrofike ekonomike të Evropës gjatë dy dekadave të fundit krahasuar me ne, me Shtetet e Bashkuara ose me pjesën tjetër të botës ». Z. Bootle është anëtar i një grupi ekonomistësh të pavarur, ‘Economists for Free Trade’ (i quajtur më parë Economists for Brexit), i cili kritikon shpenzimet dhe kufizimet e vendosura nga Brukseli dhe Brexit-in e konsideron si kusht për vazhdimin e heqjes së rregullorëve financiare në Mbretërinë e Bashkuar.

Projekti i financuesve pro-Brexit paraqitet në këtë mënyrë: City do të shndërrohet në një lloj platformë offshore. Bankieri dhe ish-trader Marc Fiorentino shpjegon : « Financuesit ëndërrojnë që Londra të bëhet një Singapor në një shkallë globale, një zonë krejtësisht të lirë nga çdo kufizim rregullues evropian, ku të gjitha fuqitë ekonomike dhe financiare në zhvillim do ta zhvillojnë lirisht biznesin e tyre, të pastërt apo deri dikund të pastër, domethënë një tokë e gjerë e azilit fiskal ». Një projekt i emërtuar nga shtypi britanik « Singapore-on-Thames ».


Një shenjë e kohës, bosët e financimit të dytë kanë filluar të vendosen në Westminster me ardhjen e z.Boris Johnson në zyrën e tij, në adresën 10 Downing Street në vitin 2019. Sikurse në tridhjetë vitet e fundit janë të mirëpritur në atë adresë përfaqësuesit e sektorëve tradicionalë të financave, siç janë zonja Andrea Leadsom, bankiere investimesh në bankën Barclays dhe sekretare e shtetit për biznes, energji dhe strategji industriale, ose z.Sajid Javid, bankier investimesh në Deutsche Bank dhe kancelar i Thesarit (ministër i financave) deri në muajin shkurt 2020. Por tani ata janë në konkurrencë me përfaqësuesit e financave të reja. Z.Richard Tice, menaxher në sektorin e patundshmërisë, u zgjodh eurodeputet në vitin 2019. Udhëheqës historik i grupit Leave Means Leave, ai u emërua të njëjtin vit kryetar i Brexit Party nga z.Nigel Farage. Bashkëthemeluesi i fondit mbrojtës (hedge fund) ‘Somerset Capital Management’, z.Jacob Rees-Mogg mori pozitën e Ministrit për Marrëdhëniet me Parlamentin. Dhe në fund, z.Rishi

Sunak, ish-menaxher i fondit mbrojtës ‘The Children’s Investment Fund Management’ u emërua Kancelar i Thesarit, duke zëvendësuar z.Javid në shkurt të vitit 2020.

Projekti Brexit nuk frymëzohet aq nga idetë neoliberale themeltare të konstruksionit evropian sa nga ideologjia libertariane. Libertarianizmi mund të përkufizohet si një doktrinë ekonomike e cila synon të kufizojë çdo formë të ndërhyrjes së shtetit jashtë garancisë së pronës private kundër kolektivizmit dhe etatizmit. Kjo ideologji ka të bëjë edhe me marrëdhëniet ndërmjet vendeve. Ajo i nxit promovuesit e saj të marrin pozicione izoluese, por jo proteksioniste. Kundërshtimi ndaj çdo institucionalizimi të marrëdhënieve ndër-shtetërore i përgjigjet refuzimit të rregullimit të shtetit. Forma e këtij kundërshtimi i lihet vlerësimit vetëm të palëve që bëjnë marrëveshje tregtare sipas interesave të tyre ekonomike.

Libertarianizmi mbështet një kapitalizëm plotësisht jonormativ si sistem i vetëm shoqëror, i bazuar në njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave të individit, dhe si një opsion politik që mënjanon çdo detyrim në marrëdhëniet shoqërore. Ai synon të krijoj një shoqëri bazuar vetëm në sovranitetin moral, politik dhe ekonomik të individëve. Në dhjetor të vitit 2019, Chris Hattingh, analist për ‘Free Market Foundation’, një think tank libertarian i themeluar në vitin 1975, shkroi: « Është rrënjësore t’u ipet njerëzve liri të tregtisë. Është rrënjësore t’u lejohet krijimi i ndërmarrjeve të reja, pa kurrfarë rregullore. Është rrënjësore që njerëzit të njihen si individë të ndryshëm, të cilët janë të aftë për ta kërkuar lumturinë e tyre siç e përcaktojnë vetë ». Siç shkruan Gilles Dostaler, libertarianët shkojnë më larg se neoliberalët kur bëhet fjalë për zvogëlimin e rolit të shtetit, « pasi që roli i shtetit duhet të largohet jo vetëm nga arsini dhe shërbimet e disa infrastrukturave siç është transporti, por edhe nga funksionet sovraane. David Friedman, djali i Milton, propozon të privatizojë policinë, drejtësinë, mbrojtjen. Lëvizja anarko-kapitaliste parashikon shuarjen totale të shtetit me privatizimin e të gjitha funksioneve të tij, duke përfshirë ato që ia rezervonte Adam Smith: ushtrinë, policinë, drejtësinë ».

Libertarianizmi nuk propozon një artikulum sistematik midis veprimeve individuale dhe një forme të së mirës së përbashkët. Liberalizmi Smith-ian e kuptonte interesin e përgjithshëm si rezultat i bashkimit të interesave individualë sipas komizës së ligjeve të miratuara në mënyrë demokratike nga individët sovranë. Neoliberalizmi i Friedman, Friedrich Hayek ose Ludwig von Mises e rivendosi të mirën e përbashkët në fushën ekonomike, por vazhdoi ta llogariste si një qëllim të doktrinë ekonomike. Mbrojtja rrënjësore e pronës private dhe liria për t’u pasuruar supozonte rritjen e përgjithshme të pasurisë dhe prandaj progresin shoqëror. Libertarianizmi, përkundrazi, mbron një qasje etike ndaj lirisë pa marrë parasysh efektet e saj në të mirën e përbashkët: promovimi i lirisë është i drejtë dhe i dëshirueshëm mbi të gjitha, pa marrë parasysh pasojat. E arsyetoni kapitalizmin pa kufizime, ngase e konsideron si i vetmi sistem ekonomik



që përputhet me etikën libertariane, dhe jo ngase beson në epërsinë e kapitalizmit, i cili gjeneron më shumë pasuri se çdo mënyrë tjetër e prodhimit. Ndryshe nga liberalët dhe neoliberalët, të cilët ndjekin një qëndrim konsekuencialist ndaj lirisë, libertarianët kanë një qëndrim deontologjik ndaj saj: liria për të akumuluar bëhet vetarsyetime i saj.

Libertarian në rrafshin ekonomik, regjimi politik i akumulimit i promovuar nga financuesit e dytë është gjithashtu autoritar në rrafshin politik. Në kundërshtim me çdo mekanizëm rishpërndarës që i garanton kushtet elementare të ekzistencës për popullatën (shëndetësi, arsim, mbrojtje), ky regjim e shndërron shtypjen e lëvizjeve shoqërore dhe zvogëlimin e lirisë publike – në veçanti duke forcuar kontrollin e lëvizjeve dhe shprehjes – në metodën e privilegjuar të krijimit të një rendi shoqëror. Kjo është vetëm në dukje kontradiktore me ideologjinë libertariane. Edhe pse nuk përfshihet në bazën e parimeve të saj, ajo është pasojë praktike e saj. Pasi që nuk ekziston një sistem për justifikimin sistematik dhe me mekanizma material për t’i kompensuar pabarazitë dhe varfërimin e një pjese të popullsisë, mbetet vetëm përdorimi i forcës si një mënyrë e rregullimit të jetës shoqërore. Liritë flijohen për hir të ruajtjes së lirisë më të rëndësishme: lirinë e pronës dhe e akumulimit.

Gjatë viteve 2010, këto ide u përhapën në veçanti përmes një grupi think tank zakonisht i quajtur “Tufton Street”, duke iu referuar Westminster Street, në Londër, ku gjinden selitë e shumicës së tyre. Në numrat 55 dhe 57 të kësaj rruge, gjenden Adam Smith Institute, TaxPayers’ Alliance, Leave Means Leave, Global Warming Policy Foundation, Center for Policy Studies dhe Institute for Economic Affairs. Këto think tanks financohen kryesisht nga sektorët e financimit të dytë, si dhe nga sektorët e tjerë ekonomikë partnerë (siç është sektori i ndërtimit dhe i shërbimeve

publike, industria e energjisë fosile dhe e duhanit). Ky rrjet nuk është vetëm britanik: Tufton Street është pjesë e labirintit transatlantik të Atlas Network (“Rrjeti Atlas”). Këto katërqind organizata formojnë një galaktikë koherente politikisht, të përcaktuar nga libertarianizmi i tyre dhe nga lidhjet e tyre me “të djathtën alternative” amerikane (alt-right) si dhe me konservatorët pro-Brexit të Mbretërisë së Bashkuar. Ato grumbullojnë një sërë idesh që përbëjnë projektin politik të financimit të dytë: libertarianizëm, vazhdimi i veprimtarisë së Thatcher, euroskepticism, atlanticizëm, autoritarizëm dhe skepticism lidhur me ndryshimet klimatike.

Për të qeverisur, duket se promovuesit e “financimit të dytë” nuk kanë më nevojë për demokracinë. Kështu, ata kundërshtojnë idenë marksiste, sipas së cilës republika demokratike është forma e qeverisjes më e përshtatshme për dominimin borgjez. Pjesërisht nga fakti se këta pushtues të rinj nuk kërcënohen nga një elitë tjetër konkurrese në ushtrimin e pushtetit. Në fillimin e shekullit XIX, ka qenë jetësore që borgjezia në rritje të fitonte një legjitimitet tjetër përveçse legjitimitetin nga lidhja e gjakut përballë interesave të grupeve feudale dhe aristokratike, që ende ishin shumë të popullarizuara në disa fshatra. Borgjezisë iu desh të luftonte kundër reformimit të mundshëm të koalicionit të interesave midis aristokracisë së tokës dhe klasave fshatare, që kishin dominuar për gati një mijë vjet. Në këtë kontekst, rishpikja demokratike e mbështetur në idenë e një populli sovran mbështeste revolucionin borgjez. Por, për momentin, borgjezia nuk është në konkurrencë me ndonjë klasë tjetër që është kandidate për pushtet. Dhe, në mungesë të një kërcënimi monarkik ose socialist, a ka ende interes për demokraci?

* Sociologë, autorë të La Finance autoritaire. Vers la fin du néolibéralisme (Raisons d’agir), 2021, prej nga është marrë ky tekst.

KUR PEKINI IMITON HARVARDIN

Trajnimi sipas stilit amerikan për drejtuesit kinezë

Presidenti Xi Jinping vazhdon t'i përbuzë vlerat perëndimore dhe t'i lavdërojë "karakteristikat kineze". Megjithatë, autoritetet në vendin e tij kanë përshtatur programin e Shkollës së Administratës Publike të Universitetit prestigjioz të Harvardit për t'i trajnuar zyrtarët e tyre. Mijëra agentë ndjekin këtë diplomë master; përruar në fillim të viteve 2000 dhe përshtatur me kontekstin kombëtar.

NGA ALESSIA LO PORTO-LEFÉBURE*



Si shpjegohen performancat spektakolare të Kinës, gjatë rrugës për t'u bërë një superfuqi në kërkimin shkencor, arsimin dhe teknologjinë, ndërsa regjimi mbetet autoritar dhe madje bëhet gjithnjë e më shumë liri-shkatërrues? Si mundet që ky sistem, në fuqi që nga viti 1949, të jetë në të njëjtën kohë jodemokratik, inovativ dhe nxitës i të qenit i hapur për shumëçka ndërkombëtare? Sot më shumë se kurrë, larg nga të qenit në kundërshtim me regjimin, ngritja e ekonomisë së Kinës i detyrohet shumë administratës së saj publike: “Janë nëpunësit e administratës që zbatojnë reformat dhe hedhin themelet institucionale për të arritur objektivin e Kinës: shoqëri e mirëqenies”, shpjegon Li Jing, profesor i shkencave politike në Universitetin e Pekinit dhe i diplomuar në Harvard.

Zhvillimi i shërbimit publik bazohet në trashëgiminë e “socializmit me karakteristika kineze” teorizuar në vitet 1980 nga Deng Xiaoping, në një model tregu kapitalist,

duke kombinuar kulturën e konsumit dhe një planifikim të fortë. Gjatë 40 viteve të kaluara, në këtë sistem ku Partia Komuniste Kineze (CCP) kontrollon shtetin që kontrollon ekonominë, administratës i është dashur të mësojë të ndërveprojë me sektorin privat dhe të provojë vazhdimisht legjitimitetin e saj për të ndërrhyrë në çështje gjithnjë e më komplekse dhe teknike.

Në sytë e të huajve, funksioni publik kinez mbetet i fshehur dhe pak i njohur. Vetëm drejtuesit e lartë kanë një famë të caktuar mediatike. Dihet se, për gati njëzet vjet, disa mijëra punonjës të sektorit publik kanë marrë një Master në Administratën Publike (MAP) të importuar drejtpërdrejt nga Shtetet e Bashkuara, duke marrë si model John F. Kennedy School of Government të universitetit të Harvardit.

Themeluar zyrtarisht në Kinë në 1999 dhe aktive që nga fillimi i vitit shkollor 2001, MAP ka për qëllim që të trajnojë profesionistë, pas të paktën tre vjet përvojë pune, kryesisht në

autoritetet lokale, por edhe në ndërmarrjet publike ose në shoqata joqeveritare. Punonjësit në sektorin privat gjithashtu mund të kenë qasje në të.

Përdorimi i modeleve dhe praktikave arsimore të prodhuara nga Amerika hegjemonike për të skalitur kulturën profesionale të elitave administrative duket se bie në kundërshtim me ambicien e CCP për t'i ofruar botës një shembull modernizimi të pavarur dhe alternativ ndaj kapitalizmit perëndimor. Disa e panë atë si një Kalë Troje të forcave të reja të demokratizimit të brendshëm të Partisë: një instrument i hapjes ndaj përvojave të huaja, programi mund të ndikojë në elitat e reja kineze dhe të çojë në një tranzicion drejt një regjimi demokratik. Por nëse MAP është arma e fshehtë e reformatorëve, pse është mbështetur dhe inkurajuar prezantimi i saj në Kinë kaq fuqimisht nga qeveria?

Misioni i tij, siç përshkruhet nga Universiteti Tsinghua (Pekin), është “të përgatitet për sfidat e udhëheqjes dhe

menaxhimit në sektorin publik”. Ajo është pjesë e një procesi inovacioni dhe përmirësimi të cilësisë së tij. Sidoqoftë, ndryshe nga sa praktikohet në shkollat e partisë dhe shkollat e administratës, kandidatët, mbajtës të të paktën një diplome të nivelit bachelor, pranohen në provim, pavarësisht nga anëtarësia e tyre në PCC ose gradën e tyre hierarkike në administratën e tyre të origjinës (shih kuadratin më poshtë).

Çuditërisht, projekti MPA u krijua në universitete, të cilat deri atëherë ishin marginalizuar në trajnimin e drejtuesve dhe punonjësve të sektorit publik. Gjithçka sugjeron, megjithatë, që programet e vjetra dhe të reja mund të bashkekzistojnë sepse ato shërbejnë për qëllime të ndryshme.

Kjo zhvendosje e trajnimit për në universitete ndodhi në vitet 1990, kur, në të gjithë planetin, u vlerësua ekspertiza shkencore, veçanërisht ajo që vinte nga institucionet e klasit botëror, dhe madje më shumë nga universitetet amerikane të

punëve kërkimore. Kjo konvergencë e normave dhe besimeve shpjegon pjesërisht pse qeveria kineze inkurajoi kurse të ofruara nga universiteti, të konsideruara më pas neutrale dhe shkencore. MAP sigurisht që mund të dobësonte burokracinë duke e ekspozuar atë ndaj ideve të huaja, por rrënjët akademike mbi të gjitha mund t'i jepnin asaj legjitimitetin profesional të nevojshëm për të mbijetuar.

Një shekull shkëmbimesh akademike

Kjo zgjedhje ishte pjesë e një projekti më të madh, qëllimi i të cilit ishte të mbështeste kalimin në një ekonomi tregu duke përvetësuar dhe forcuar aftësi teknike, për të përmbushur pritshmëritë e një tregu pune në rrugën e diversifikimit dhe sofistikimit. Prandaj, Kina nisi një valë krijimi të gradave profesionalizuese të frymëzimit amerikan, të gjitha besuar universiteteve: masteri në administrim biznesit (Master of Business Administration, MBA) në 1991, i ndjekur nga

MARRËVESHJA MË E MADHE TREGTARE E BOTËS

Bomba e tregtisë së lirë në Azi

Asnjë armëpushim nuk pritet në përballjen mes Kinës dhe Amerikës. Pekini ka fituar avantazh duke nënshkruar partneritet ekonomik rajonal global me katërmëdhjetë vende të tjera aziatike, si marrëveshja më e madhe e tregtisë së lirë nënshkruar ndonjëherë në botë. Më shumë sesa përfitimet ekonomike, kjo marrëveshje sjell imazhin e një Azie dinamike, e cila di të ketë marrëdhënie të mira me vendet e tjera, pavarësisht nga ndryshimet e saj politike dhe strategjike.

NGA MARTINE BULARD

Tuhet se është e dobët, e ndarë, joefektive, madje edhe inekzistente. Shoqata e Kombeve të Azisë Juglindore (Anase, ose Asean në anglisht) është një nga ato organizata rajonale që duken se qëndrojnë jashtë radarit diplomatik, edhe nëse bashkon dhjetë vende (Birmanian, Brunei, Kamboxhia, Indonezia, Laos, Malajzia, Filipinet, Singapori, Tailandia, Vietnam) dhe 652 milion njerëz. Për më tepër, samiti i saj i 37-të u hap pa probleme, në Hanoi në 12 nëntor. Por ajo përfundoi, tre ditë më vonë, me zhurmë: nënshkrimi i një marrëveshje të tregtisë së lirë, Partneriteti Ekonomik Rajonal Gjithëpërfshirës (PERG; në anglisht: Regional Comprehensive Economic Partnership, RCEP) me Australinë, Kinën, Korenë e Jugut, Japoninë dhe Zelandën e Re.

Në një kohë kur zhvendosja e prodhimit, “konsumit vendor”, ku mbrojtja e tregut duhet të shërbejë si bazë për një mënyrë të re zhvillimi, vendet kryesore aziatike (me përjashtim të Indisë, e cila u tërhoq nga negociatat nga frika e konkurrencës nga fqinjët e saj) mbështeten në shtrirjen e fushës së globalizimit. “Një fitore për multilateralizmin dhe tregtinë e lirë”, i uroi mirëseardhjen kryeministrit kinez, komunistit Li Keqiang, ndërsa homologu i tij japonez, liberali Suga Yoshihide, e mbështeti këtë “ditë historike, pas tetë vjetësh negociatave”, dhe bëri thirrje që marrëveshja të zbatohet sa më shpejt të jetë e mundur”. Tregtitë e lira të të gjitha vendeve, bashkohuni!

Tridhjetë përqind e pasurisë së prodhuar në botë, 28% e tregtisë botërore dhe 2.2 miliardë njerëz: PERG është marrëveshja më e madhe e këtij lloji e nënshkruar ndonjëherë. Pa Washingtonin! Ishte një ndryshim i veçantë i historisë për të parë Kinën që mbretëronte me madhësi në këtë Azi Juglindore kaq armiqtë.

Bashkim i pazakontë

Në të vërtetë, Anase u themelua në vitin 1967, në mes të Luftës së Ftohtë, me synim për ta ruajtur komunizmin. Thelbi i “vendeve të sigurta”, që shpesh kanë gjuajtur “të kuqtë” në territorin e tyre dhe aleatë të Shteteve të Bashkuara, duke përfshirë Indonezinë, Malajzinë, Filipinet, Singaparin dhe Tajlandën, ishin mbledhur për ta bllokuar “të keqen”. Por, me kohën dhe shembjen e Bashkimit Sovjetik, grindjet ideologjike u zbehën. Kriza aziatike e viteve 1997-1998, e cila shkatërroi rajonin ndërsa ekonomia kineze po ngrihej, bëri pjesën tjetër: armiqtë e së kaluarës negociuan, Anase u konsolidua. Pastaj u përhap duke krijuar atë që quhej Anase + 3, me tre gjigandët aziatikë (Kina, Koreja e Jugut dhe Japonia), si dhe një sërë organizatash me gjeometri të ndryshueshme, siç është Forumi rajonal i Anase, i cili ka njëzet e shtatë anëtarë (përfshirë ata të Anase + 3, Shtetet e Bashkuara, Koreja e Veriut, Rusia, India dhe Bashkimi Evropian), ose Takimi i Ministrave të Mbrojtjes Plus (Asean Defense Ministers Meeting Plus), i cili bashkon tetëmbëdhjetë vende (ato të Anase + 3, Australia, Shtetet e Bashkuara, India, Zelandë e Re, Rusia).



Në heshtje, Anase ka thurur një rrjet të gjerë diplomatik që pa dyshim ka parandaluar përshkallëzimin e konflikteve territoriale në Detin e Kinës, pa arritur t'i zgjidhë ato. Në vitin 2018, ajo hartoi me Pekinin një kod sjellje (COC) për të shërbyer si një bazë për negociatat midis të gjithë atyre që pretendojnë sovranitetin mbi Ishujt Paracels dhe Spratleys: Kina, i kërkon të gjitha; Vietnam, Filipinet, Malajzia, Brunei dhe Indonezia janë më pak lakmatarë, por pretendimet kombëtare ngatërrohen. Dy vjet më vonë, COC has në një ngërç, incidentet përhapen dhe inatet rriten.

Sidoqoftë, tensionet nuk e penguan nënshkrimin e PERG-ut, i cili bashkon fuqitë e dyta dhe të treta më të mëdha ekonomike në botë – Kina dhe Japonia, rreth të njëjtit tekst. Kontrata prej 521 faqesh (në anglisht), 20 kapituj, 17 anekse dhe një kalendar për hyrjen në tregjet kombëtare synon t'i “eliminonë tarifën e doganës dhe kuotat për mallrat”, thotë faqja e internetit të Anase. Ajo mbulon gjithashtu disa pengesa jotarifore (në lidhje me standardet), pjesën e tregtisë së shërbimeve, tregtisë elektronike dhe çështjeve të pronësisë intelektuale, por lë jashtë pjesën më të madhe të produkteve bujqësore.

Në fakt, rregullat duket se nuk janë kufizuese: një produkt i bërë nga materiale me origjinë nga një nga pesëmbëdhjetë vendet nënshkruese do të pranohet automatikisht të tjerët. Kjo, si parantezë, do të ketë pasojë për Bashkimin Evropian, i cili ka nënshkruar marrëveshje të tregtisë së lirë me disa vende që janë pjesë e PERG (Vietnam, Koreja e Jugut, Japonia). Do të bëhet më e vështirë, nëse jo e pamundur, të gjurmohet origjinën e produkteve, të cilat më pas mund të përfitojnë nga trajtimi preferencial evropian.

PERG nuk mban asnjë kriter mjedisor, shëndetësor apo shoqëror. Pa dyshim, marrëveshjet nën kujdesin amerikan ose evropian, megjithë formulën e tyre të bukur, nuk shërbejnë për gjë -përveç klauzolave shoqërore si paga minimale ose e drejta për grevë e prezantuar në 2018 në rishikimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Amerikës së Veriut (Alena). Nga ana tjetër, PERG nuk përmban ndonjë

klauzolë që u jep fuqi internacionalëve për të sulmuar shtetet kur masat nuk i kënaqin ato. Asnjë rol nuk i është caktuar Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (Cirdi), gjykatë e jashtëzakonshme mbi ligjet kombëtare.

Në përgjithësi, nënshkrimi i një marrëveshje të tregtisë së lirë krijon një grumbull premtimeve (asnjëherë të pëmbushura) mbi rritjen e ekonomisë, vendet e punës ose tregtinë. Këtë herë, edhe ekspertët më liberalë të ekonomisë mbeten të kujdesshëm dhe presin në rastin më të mirë një rifillim të rritjes me mesatare prej 0.2 deri në 0.4%. Në fakt, shumica e vendeve të interesuara tashmë kanë marrëveshje bilaterale të tregtisë së lirë, veçanërisht me tre superfuqitë, ndërsa zonat e veçanta ekonomike (pa taksim) janë grupime në rajon: ka 700 në Azinë Juglindore dhe më shumë se 2,500 në Kinë.

Ndryshimet e pritshme, të kufizuara, nuk do të jenë as të njëjtat dhe as të dobishme për të gjithë, edhe nëse PERG synon zyrtarisht të promovojë “integrimin ekonomik aziatik”. Anase mbetet një mbledhje e zymtë e vendeve me nivele shumë të ndryshme pasurie. Në krye të tabelës, Singapori, me të ardhura prej 64,567 dollarë për frymë, nuk ka shumë të bëjë me Birmaninë dhe 1,440 dollarët e saj për frymë. Në Brunei, 78% e popullsisë jeton në qytete, por në Kamboxhia jeton vetëm 23%. Nevojat dhe qëndrueshmëria e tyre nuk janë të njëjtit rend. Duke qenë në kërkim të vendeve të reja me paga të ulëta, internacionalët nga rajoni dhe pjesa tjetër e botës, nga ana e tyre, do të jenë të kënaqur. Vietnam tashmë po përfiton nga zhvendosja e fabrikave të vendosura më parë në Kinën fqinje. Tokio ka miratuar një plan për t'u shkëputur nga Kina, duke ndihmuar grupet japoneze të zhvendosen në ishull ose të investojnë në Vietnam, Birmani ose Tajlandë. Japonia, ekonomia e së cilës është një nga më të fuqishmet, është ofruesi kryesor i fondeve në Azi: përfaqëson 13.7% të investimeve të huaja direkte (IHD) që hyjnë në Anase, përkundrajt 7% të Kinës. PERG duhet të çojë në një rishpërndarje të kartave brenda zonës, por sigurisht jo në një përmbyesje.

Interesi themelor i kësaj marrëveshjeje

qëndron në dimensionet e saj strategjike, pasi ajo sakrifikon centralitetin gjeopolitik të Kinës. Fillimisht nisur nga Pekini, në përgjigje të Partneritetit Trans-Paqësor (PTP, TPP në anglisht) ideuar nga Z. Barack Obama kur ai ishte President i Shteteve të Bashkuara për të ndaluar rritjen e fuqisë kineze (braktisur nga Z. Donald Trump), PERG u rrotullua për tetë vjet. “Diplomacia e bashkëpunimit” të Anase, sipas thënies, dhe vullneti kinez për të patur sukses çoi përfundimisht në nënshkrimin e marrëveshjes.

Një i krishterë që dëshiron të mbetet anonim pëshpërit se « autoritetet greke janë mbytur. Turqia, e cila është shumë më e pranishme në terren, ka më shumë fuqi. Ankaraja ka mijëra spiunë në rajon dhe i jep miliona euro buxhet çdo vit konsullatës turke në Komotini”. Për zonjën Hayrullah, e cila është afër këtij institucioni, “konsullata përbush vetëm një mision diplomatik, si konsullata greke e Edirne [qyteti turk rreth 200 kilometra në kufi]”. Pamja e konsullatës turke bie në kontrast me fasadat e dëmtuara të Komotini. E survejuar nga kamerat dhe rojet, ndërtesa është e rrethuar nga barriera të gjata të gjelbërta.

“Greqia po na trajton mirë. Ajo është e interesuar në zhvillimin e komunitetit dhe na lejon të praktikojmë fenë tonë”, krenohet z.Selim Isa, në zyrën e tij të qetë. Kryetari i Komitetit të Menaxhimit të Pronave Myslimane – i emëruar nga shteti Grek – është krenar që tregon llambadarët e bukur dhe dhomat e ndritshme, të rinovuara të një prej 20 xhamive të Komotini-s. “Por sa më shumë marrëdhëniet me Turqinë të përkeqësohen dhe sa më shumë që konsullata të zgjerojë ndikimin e saj, aq më shumë ajo pretendon njohjen e një pakice turke”, shton Isa, duke vërejtur vigjilent, ndërsa thirrja e myezinit jehon nëpër qytet.

Në një mesazh me video dërguar më 7 dhjetor në seminarin për Mesdheun Lindor të organizuar nga Këshilli i Universiteteve Ndërkombëtare dhe Universiteti Akdeniz në Antalia, z.Erdoğan, i vendosur për të rishikuar hartat në Mesdheun Lindor, denoncoi “mentalitetin pirat që dëshiron të na vjedhë të drejtat”. Presidenti turk nxiti gjithashtu Bashkimin Evropian të ndalojë së qeni “i padrejtë ndaj qipriotëve turq dhe Turqisë”, në emër të “solidaritetit të Bashkimit”.

*Gazetare, Athinë.

SERBI

Bendet muzikore neonaziste serbe të përkëdhelura nga shteti

Skena e rockut neonazist e lindur në Serbi gjatë viteve të luftës vazhdon të veprojë nën petkun e 'patriotizmit'. Këto grupe të supremacisë së bardhë vazhdojnë të përhapin këngët e tyre urrejtëse ndaj hebrenjve, homoseksualëve, minoriteteve dhe refugjatëve, pa u ndëshkuar nga zbatuesit e ligjit në fuqi.

NGA DUSHAN KOMARÇEVIQ DHE MAJA ZHIVANOVIQ

Shpalosin simbolet fashiste pa ndonjë ngurrim duke i konsideruar si shenja mbrojtëse. Hera e fundit ishte të shtunën në mbremje, më 10 tetor, në Beograd.

Deri në momentin e fundit nuk dihej nëse policia do ta ndalonte koncertin në nder të Ian Stuart Donaldson (1957 – 1993), themeluesin e organizatës ndërkombëtare neo-naziste “Blood&Honour” (Gjaku dhe Nderi), e cila ka degën e saj edhe në Serbi. Në fund, megjithatë u ndalua koncerti i planifikuar të mbahej në ndërtesën e BIGZ të kryeqytetit serb.

“Blood&Honour” është një nga organizatat e këtij lloji, e cila përmendet shpesh në publik. Sipas hulumtimit nga Radio Evropa e Lirë (REL), grupe të tilla, si ‘Sorab 28’, ‘Providence’, ‘Crystal Night’, ‘Terror 88’ dhe ‘From the Revolt’ kanë performuar me koncerte të mbyllura për publikun e gjerë, në gjithë vendin, përgjatë katër viteve të fundit.

Mesazhet e tyre janë mishërim i fashizmit, jotolerancës nacionaliste, shovenizmit serbomadh dhe sipas aktualitetit, edhe qëndrimeve kundër migrantëve. Nuk gjejnë frymëzim vetëm të nazistët, por edhe të udhëheqës të serbë nga luftërat e viteve ‘90, shumë prej të cilëve tashmë janë edhe të dënuar për krime lufte. Ndikimi i grupeve të tilla në Serbi mund të hetohet pjesërisht, por mbetet për t’u interpretuar arsyet pse shteti nuk i zbaton ligjet e veta që ndalojnë këtë lloj veprimtarie.

Glorifikimi i antisemitizmit dhe ksenofobisë

Shumica e grupeve që Radio Evropa e Lirë ka konfirmuar që janë ende aktive, nuk kanë llogari zyrtare në rrjetet e popullarizuara sociale, si Facebook, Instagram ose Twitter. Megjithatë, ata po gjejnë mënyra për të përhapur muzikën e tyre në platformat e internetit.

Një prej tyre është platforma ‘Bitchute’, që është një alternativë ndaj YouTube, që nuk i fshin përmbajtjet që promovojnë gjuhë të urrejtjes. Në këtë platformë është aktiv bendi hard core nga Serbia, ‘Terror 88’. Numri 88 përfaqëson ekuivalentin numerik të shkronjave H H në alfabetin latin duke përfaqësuar përshëndetjen naziste “Heil Hitler”. ‘Terror 88’ ka pak më shumë se 30 ndjekës në rrjetin social VKontakt i cili është ekuivalenti rus i Facebook. Ka edhe webfaqen e tij që tregon se bendi ka publikuar një përmbledhje të këngëve të përzgjedhura nga aktiviteti 15 vjeçar. Në mesin e tyre është edhe kënga e titulluar

“28”, që është simboli numerik që shpërfaq shkronjat B dhe X, të cilat përfaqësojnë inicialet e organizatës “Blood and Honor”.

Në njërën nga këngët e interpretuara në gjuhën serbe, në frymën e antisemitizmit që kulmoi në shekullin XX, kur Gjermania naziste kreu Holokaustin kundër këtij grupi etnik, hebrenjtë paraqiten si “kërcënim për racën e bardhë”: “Hebrenjtë duan përmbytjen tonë / ne do t’ruajmë krenarinë dhe racën / do t’fillojmë revolucionin e bardhë”.

Sipas të dhënave nga bllogu neo-nazist ‘Rock against communism’ (Rock kundër komunizmit), ky grup ka pasur disa performansa në Serbi më 2016, duke përfshirë edhe një koncert në një vend të panjohur për nderim të Donaldson.

Këngët e bendit ‘Luger’, të emërtuara sipas modelit gjerman të armës, mund të gjenden në platformën YouTube. Kënga e tyre e fundit u publikua në gjuhën serbe një muaj më parë duke përhapur publikisht ksenofobi kundër refugjatëve dhe migrantëve nga Lindja e Mesme dhe Azia. Teksti jep mesazhin vijues:

“Nuk keni çfarë kërkoni këtu / ky vend e nënqiell nuk është i juaj / shporruni jashtë, talibanë të ndyrë / kjo është Serbia, vend qiellor /, thuhet në këngën të cilën sipas të dhënave në YouTube e kanë dëgjuar deri tani më pak se 100 persona.

Marija Gjoriq, eksperte për ekstremizmin dhe bashkëpunëtore kërkimore në ‘Institutin për studime politike’, shpjegon se muzika “White Power” ose muzika “fuqia e bardhë”, është një shembull i propagandimit të racizmit përmes muzikës. “Unë do të thoja që racizmi në këtë kontekst nuk duhet të nënvlerësohet, për arsyen e thjeshtë që Shekspiri pohoi se muzika është ushqim i shpirtit. Nëse rinia jonë ‘ushqehet’ me muzikë dhe me përmbajtje të tillë ideologjike, atëherë kjo është shumë e rrezikshme”, thotë Gjoriq për REL.

Marija Gjoriq shpjegon po ashtu se kjo skenë në Serbi është modeluar kryesisht duke imituar ngjarje nga rajone të Evropës perëndimore, ndërkohë që dominon filiali i grupit ‘Blood and Honor’. “Ata kanë degë në gjithë botën, përfshirë edhe në vendin tonë, ku kanë shtëpi botuese, radiostacione dhe një produksion shumë të pasur që po reflektohet edhe në vendin tonë. Kjo muzikë përdoret për një rekrutim perfid të rinisë dhe për këtë arsye ndikimi i saj duhet të merret parasysh”.



Muzika si mjet propagande

Me rastin e themelimit të ‘Blood and Honor’ më 1987, Ian Stuart Donaldson vendosi përhapjen e ideve neonaziste përmes muzikës, si një nga qëllimet e organizatës. Udhëheqësi ideologjik i këtij rrjeti neonazist ishte edhe këngëtar i grupit ‘Skrewdriver’ për një dekadë. Ky grup është sot sinonim i rockut neonazist.

Bendi u shpërbë dy vjet pas publikimit të albumit të tij të parë “All Skewed Up” (1977) i cili nuk kishte gjurmë të ideologjisë neonaziste. Donaldson solli muzikantë të rinj në bend dhe më vitin 1982 publikoi një album tjetër: ‘Hail the new down’ (‘Lavdi agimit të ri’), me të cilin Skrewdriver filloi një udhëtim muzikor duke i qëndruar besnik Donaldsonit deri në vdekjen e tij gjatë një aksidenti automobilistik më 1993, kur edhe ky bend u shpërbë.

Bendi ishte një nga simbolet kryesore të lëvizjes ‘Rock Against Communism’ (RAC – Roku kundër komunizmit) i cili u shfaq në fund të viteve 1970 si një kundërvënie ndaj fushatës “Rock Against Racism” (Roku kundër racizmit) të inicuar nga disa muzikantë rock dhe rege në Mbretërinë e Bashkuar që kundërshtonin ksenofobinë dhe racizmin në rritje. Albumi i tretë i Skrewdriver, “Blood & Honor” i publikuar më vitin 1985 ishte edhe njoftim për formimin e organizatës me të njëjtin emër. Donaldsoni e gjeti frymëzimin për këtë emër në sintagmën e rinisë hitleriane (“Blut und Ehre”). Kjo organizatë shpesh përfaqësohet nga numri 28 që tregon

numrat rendorë të shkronjave B dhe H në alfabetin latin.

Këngët që himnizojnë spastrimin etnik

Kjo organizatë ka publikuar deri më sot kompilime të shumta bendesh që glorifikojnë racën e bardhë, ideologjinë naziste dhe udhëheqësit e Rajhut të Tretë.

Dega serbe “Krv i časti” (“Gjaku dhe Nderi”) u themelua më 1995, të njëjtin vit kur përfunduan luftërat në Kroaci dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, ku Serbia mbështeste palën serbe në ato luftëra, e ku ndër të tjera realizuan spastrimin etnik masiv të popullsisë joserbe dhe kryen gjenocidin në Srebrenicë.

Sipas informacionit nga portali “Discogs”, që është një platformë në internet me të dhëna për muzikantët dhe diskografitë e tyre, “Krv i čast – Srbija” më 1998 publikoi albumin e tij të parë të titulluar “Athens of ethnic cleansing” (Himnet e spastrimit etnik).

Albumi përfshin ndër të tjera edhe bendin ‘Kristalna Noć’ (Nata e Kristaltë) nga Kragujeci, një grup që ishte paralajmëruar në koncertin për përkujtimin e Donaldsonit që zhvillohej në Beograd më 10 tetor.

Ky grup publikoi albumin e tij të parë më 1998 me titullin “Vojnik revolucije” (“Ushtri i revolucionit”). Ai përfshinte, ndër të tjera, edhe këngën “Rudolf Hess”, ku grupi nderon njërin prej nazistëve kryesor në Gjermaninë e Hitlerit dhe njërin prej bashkëpunëtorëve më të afërt të Adolf Hitlerit. “Pusho në paqe, Rudolf

Hess / Njësia SS po lëviz përsëri”, është një nga vargjet e kësaj kënge.

“Nata e kristaltë”, emri i së cilës i referohet ngjarjes së nëntorit 1938, kur u shkatërruan dhe u dogjën qindra sinagoga, shtëpi dhe dyqane hebrenje në Gjermani dhe Austri dhe kur u vranë më shumë se 90 njerëz, nuk ka asnjë llogari në ndonjë platformë të njohur në internet. Në bllogun neonazist “Rock against communism” u publikuan foto nga disa shfaqje të këtij grupi gjatë vitit 2016.

Sipas raportimeve nga ky bllog, ‘Kristalna Noć’ performoi në nëntor të atij viti me një ngjarje kushtuar Ian Stewart. Vendi i koncertit nuk ishte specifikuar, mirëpo u publikuan fotot me nënshkrimet e bendeve ‘Iz Revolta’ (Nga Revolta), “Sorab 28”, “Terror 28”. Bendi i vetëm nga Serbia që mungoi ishte ‘italijanski Katastrof’ (Katastrofa Italiane).

Sipas të njëjtit bllog, në korrik të po këtij viti u mbajt “Jagodina Fest”. Përveç ‘Kristalnu Noć’ në koncert kishin performuar edhe bendet ‘Providence’, ‘Terror 88’ dhe ‘Sorab 28’. E gjithë ngjarja u shoqërua edhe me një reportazh përmes fotografive, me fytyra të fshehura të pjesëmarrësve.

Marija Gjoriq sqaron se të rinjtë hyjnë shpesh në botën e muzikës së tillë, jo vetëm për shkaqe ideologjike, por edhe për të shokuar: “Ajo që i tërheq ata në këtë rast është aventurizmi dhe rebelimi. Megjithatë, me kalimin e kohës, ata indoktrinohen dhe duke përsëritur parullat toksike naziste dhe raciste, atëherë edhe fillojnë t’ju besojnë”.

Janë edhe dy grupe të tjera nga

Jagodina që gjetën vendin e tyre në albumin ” Krv i čast ” nga viti 1998. Këto janë ‘Terrormachin’ e dhe ‘Providenje’. Nuk dihet nëse bendi ‘Terrormachine’ është akoma aktiv, por bendi ‘Providenje’ ishte paralajmëruar në koncertin për përkujtimin e Donaldsonit më 10 tetor në Beograd. Bendi është aktiv nga mesi i viteve 1990, ndërsa shtatë muaj më parë ata publikuan një album përmbledhës në platformën muzikore ‘Soundcloud’ me këngë të xhiruara brenda periudhës 1996 – 2012. Aty ka këngë që glorifikojnë Holokaustin, gjenocidin e Srebrenicës dhe ish-udhëheqësin serb të Bosnjës Radovan Karaxhiqin i cili u dënua me burg të përjetshëm nga Haga, për krime të luftës në Bosnje dhe Hercegovinë.

Në refrenin e këngës “Konačno rešenje” (Zgjidhja përfundimtare), e cila gjindet në ‘Soundcloud’, ata ju drejtohen hebrenjve (formulimi që përdorin është “hebrej të ndyrë”) duke thënë: “Njeriu i bardhë e di me ju / se shkatërrimi i racës tuaj në Evropë / zgjidhja përfundimtare”.

Sipas raportimeve nga bllogu “Rock against communism”, bendi “Providenje” performoi në qershor 2016, në festivalin e grupeve neonaziste “Europe Awake”, në Poloni. Ata ndanë skenën me bendin britanik ‘Section 88’, grupet polake ‘Obled’, ‘Odwet’, ‘M.A. T. Project’ dhe me grupin tjetër nga Serbia, ‘Sorab 28’. Bendi ‘Iz Revolta’ i cili është i vetmi që ka faqe zyrtare në rrjetin social Facebook me rreth 300 ndjekës, ishte menduar të performonte në ngjarjen e diskutueshme të BIGZ.

Në identitetin e tij vizual ata kanë një “rrotë tjerresë”, si simbol nga kultura e hershme sllave, që quhet ndryshe ‘svastika’ sllave, si dhe një variacion të shqiponjës dykrenare që u përdor gjatë qeverisë kuislinge të Millan Nediqit në Serbi përgjatë Luftës së Dytë Botërore. Sipas të dhënave nga faqja ‘Discogs’, grupi publikoi albumin e tyre të fundit “Naša scena” (Skena jonë) para dy vjetve. Mes këngëve të këtij albumi është edhe kënga “Jedan narod” (Një komb) ku thuhet: “Tani mjafton, ngre dorën / mbarë kombi tubohet / legjione të reja, për një botë më të mirë të bardhë”.

Në skenë me identitete të fshehura

Shumica e grupeve që performojnë në manifestimet neonaziste përpiqen ta fshehin identitetin e tyre dhe të anëtarëve të tyre. Ngjarje të tilla, si tubimi përkujtimor për Ian Stewart, janë të mbyllura për publikun e gjerë. Njoftimet për kohën dhe vendin e saktë merren direkt nga organizatorët, zakonisht me postë elektronike.

Prandaj, nuk është për t’u habitur që në fotot e rralla nga ngjarja, të cilat mund të gjenden në forumin neonazist ‘Stormfront’ ose në bllogun “Rock against communism”, fytyrat e anëtarëve të bendit, por edhe të pranishmit në publik janë të mbuluar në mënyrë që të mos zbulohet identiteti i tyre.

Sipas hulumtimit të REL, një nga aktorët në skenë është Boris Saviq, i cili në Instagram ka shumë fotografi që e tregojnë duke performuar në skenë me një banderolë ku shkruhet “Club 28 Serbia”, që ishte vendi ku në tetor parashihej të mbahej

një koncert i grupeve neonaziste në Beograd.

Gjithashtu, në profilin e tij, Saviq mban llogon e bendit “Kristalna Noć”, elementi i së cilës është edhe një variacion i stemës nga koha e qeverisë kuislinge të Millan Nediqit gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Më vitin 2012, Saviqi përmes rrjetit social Facebook shprehu publikisht mbështetjen për të djathtën ekstreme norvegjeze dhe terroristin Anders Breivik, i cili u dënua me 21 vjet burg për vrasjen e 77 personave, kryesisht anëtarë të të rinjve të Partisë së punëtorëve. Mesazhe si “Serbia për serbët” dhe “Vdekje shërbëtorëve të sionizmit” gjinden po ashtu në profilin e Saviqit.

Bendi ‘Sorab 28’ i cili quhej fillimisht ‘Sorab 18’ është ende aktiv në skenën serbe. Ai është ekuivalent numerik i shkronjave A dhe H, që në në gjuhën e kodit neonazist përfaqëson inicialet e Adolf Hitlerit. Krijuesi ideologjik i bendit të themeluar më 1994 në Gërjavica të Sarajevës është një njeri që në qarqet e nëntokës njihet me pseudonimin Jules.

Në një intervistë me bllogun neonazist “Hail the New Down” më 2011, Jules thotë se e themeloi bendin e parë të quajtur ‘White Riot’ (Rebelimi bardhë) më 1987, një vit pasi ishte bërë anëtar i lëvizjes ‘Skinhead’. Ai thekson se në atë kohë, jo të gjithë anëtarët e këtij grupi subkulturor ishin përkrahës të nacional-socializmit:

“Fuqia e vërtetë që bashkoi të rinjtë nga Serbia dhe Republika Srpska që respektojnë idenë e supremacisë të të bardhëve ndodhi në fillim të viteve 1990 me formimin e degës serbe ‘Krv i čast’. Merita e madhe i takon ekipit nga Jagodina (Serbi). Mendoj se lëvizja ishte në kulmin e saj më 1999, e pas kësaj ndodhën disa trazira që nuk i sillnin asgjë të mirë askujt, e për pasojë shumë njerëz u larguan nga lëvizja”.

Më 2014, grupi publikoi këngën “Sloboda za Zlatnu zoru” (Liri për Agimin e artë), duke iu referuar organizatës neonaziste greke Agimi i Artë, udhëheqësit e së cilës u dënuan nga Gjykata e Apelit në Athinë më 7 tetor 2020, për udhëheqjen e një lëvizje kriminale. Tekstet e bendit ‘Sorab 28’, të cilat i kushtohen asaj organizate, ndër të tjera thonë: “Ne e dimë të vërtetën pse po arrestoheni, pse po ju vrasin ... Mbrojeni vendin tuaj”.

Në mbrojtje të “Evropës së bardhë”, këndon edhe bendi hard core nga Jagodina ‘Savršenstvo kroz patnju’ (Përsosuria përmes vuajtjeve). Ky bend i themeluar më vitin 1994 është aktiv në rrjetin social Facebook, ku ka rreth 600 ndjekës. Në këngën “Slobodna Evropa” (Evropa e Lirë) ata e përcaktojnë veten kundër “të keqes sioniste”, “Masonëve të lirë” dhe “majmunëve afrikanë”, e ku në refrenin e njërës prej këngëve të tyre thuhet: “Evropa e Lirë – Shtëpia Arianë/ Evropa e Lirë – Njerii i bardhë në të veten / Dhe do të jetë vetëm e jona, sepse kështu duhet të jetë: Evropa e Lirë për njerëzit e lirë”. Kjo këngë ka edhe video në platformën YouTube me rreth 1400 shikime.

Në të njëjtën platformë gjindet kënga që ky bend ia kushton Millan Nediqit, kryetarit të qeverisë kuislinge serbe gjatë pushtimit gjerman të Jugosllavisë. “Ai e donte Serbinë,

Evropën dhe Rusinë / Në Serbinë e bashkuar , ai ishte shpëtimi / Kundër të keqes së komunizmit / Me forcat e nacional-socializmit / Në Evropën e re kishte vend edhe për ne”, janë fjalët e këngës “Mi te pozdravljamo, Nediću Milane” (Ne të përshëndesim, Nediq Millan). “Slava dëneralu” (Lavdi gjeneralit) dhe “Živela pobjeda” (Rroftë fitorja) janë disa nga komentet që mund të lexohen poshtë këngës. Sipas informacionit në faqen e tyre zyrtare, deri më tani, koncerti i fundit i grupit u mbajt më 2015 në klubin jagodinas ‘Talir’.

“Gjithçka u lejua nën petkun e patriotizmit”

Dashko Milinoviq, drejtues i radios në internet “Daško & Mlada.com” dhe këngëtar i grupit antifashist ‘Red Union’ thotë për Radio Evropa e Lirë se ‘Rock Against Communism’ dhe bendet neonaziste janë aktive në Serbi që nga mesi i viteve 1990, e se ato janë të lidhura me grupe simotra në nivel ndërkombëtar. Kjo ka qenë gjithmonë histori e nëntokës që përcillet nga goja në gojë dhe me promovim minimal. Kjo skenë ishte në kulmin e saj në fund të viteve 1990, kur numëronte rreth 300-400 ithtarë. Një nga bastionet e skenës rock neonaziste ishte në Jagodinë (Serbi). Por edhe në Nish, Beograd dhe për një kohë në Novi Sad”, shpjegon Milinoviq.

Sërgjan Knezheviq, ish-këngëtar i bendit punk ‘Hoću?Neću!’ (Dua?S’dua!) nga Kraleva i cili filloi të performojë në fillim të viteve 1990 dhe që mbajti qëndrime të qarta anti-nacionaliste gjatë gjithë karrierës së tij, i tha Radios Evropa e Lirë, se grupe të ekstremist të djathtë, në qytetin e tij, filluan të shfaqeshin në fillim të viteve 1990, kur skena u nda në të majtët dhe të djathtët. “Ata bën skenën e tyre, me bendet e tyre dhe koncertet e tyre. A kishin ndikim në mjedisin shoqëror? Padyshim që po. Në një moment, ata ishin numerikisht më shumë se pankerët”, kujton Knezheviqi. Sipas tij, grupeve të tilla iu dha hapësirë për t’i përhapur idetë e tyre.

“Djathtistët u përpoqën ta paraqitnin veten si pjesë të skenës alternative. Kjo i është lejuar nga organizatorët e festivaleve të kitariadës në atë kohë, sepse ata performonin në festivalet e kitarës. Më vonë, me kalimin e kohës, ata organizuan koncertet dhe tubimet e tyre. Kjo iu shkonte dorësh, sepse ata ishin të mbuluar me petkun e ‘atdhedashurisë’ i cili ishte i dëshirueshëm, edhe nëse krahas nacionalizmit të pastër dhe shovinizmit shqyeshin shijet nacistë”, thotë Knezheviqi. Ai shton se gjatë viteve ‘90, as shteti dhe as shoqëria nuk bën asgjë për t’i penguar veprimet e grupeve ekstremiste.

“Ata shprehin pikëpamjet e tyre nacistë në koncerte krejtësisht të hapura. Nuk ngurronin të njiheshin si të tillë në shoqëri dhe në rrugë. Gjithçka ishte transparente. Posterat ishin publik dhe nuk ishte sekret se kush dhe kur paralajmëronte ardhjen e tyre në qytet”, shpjegon ai. Policia nuk ndërhynte.

Pse hesht policia?

REL kërkoi një bashkëbisedues ose një përgjigje me shkrim nga Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë (MPB), për pyetjet rreth grupeve që janë ende aktive, por nuk

morëm përgjigje deri në përfundimin e këtij teksti.

Sipas Marija Gjoriqit, shteti duhet ta ndalojë promovimin e gjuhës së urrejtjes, sepse Kushtetuta e ndalon nxitjen e urrejtjes dhe jotolerancës mbi baza nacionale, racore dhe fetare. “Besoj se MPB ka kapacitete për ta luftuar këtë lloj ekstremizmi. Ata kanë mjaftueshëm njerëz të edukuar që dijnë t’i interpretojnë simbolet neonaziste dhe kjo është shumë e rëndësishme. Mirëpo, institucionet nuk mund t’u përgjigjen të gjitha kërkesave ngase këto koncerte janë kryesisht me karakter privat, e caktohen përmes forumeve duke mos qenë të njohur për publikun e gjerë”, shpjegon Gjoriqi. Fakt është që shërbimet kompetente duhet të përcjellin ngjarje të tilla, thotë ajo, sepse nga ato shkëndija mund të ndizet një zjarr i tërë. “Dukuri të tilla në shoqërinë tonë janë marginale, por ato nuk duhen nënvlerësuar”, shtoi Gjoriq.

Ç’totë ligji?

Neni 49 i Kushtetutës së Serbisë ndalon qartësisht “çdo nxitje të pabarazisë, urrejtjes dhe jotolerancës racore, kombëtare, fetare ose tjetër”. Përveç kësaj, që nga viti 2009 është në fuqi Ligji për ndalimin e manifestimeve të organizatave dhe shoqatave neonaziste ose fashiste dhe ndalimin e përdorimit të simboleve neonaziste dhe fashiste.

Neni tre i këtij ligji thotë: “Ndalohet prodhimi, riprodhimi, ruajtja, paraqitja, glorifikimi ose shpërndarja, apo çfarëdo mënyrë tjetër e materialeve propagandistike, simboleve ose shenjave që nxisin, inkurajojnë ose përhapin urrejtje ose jotolerancë ndaj përcaktimeve të lira të qytetarëve; që nxisin dhe inkurajojnë urrejtje dhe jotolerancë racore, kombëtare, fetare, si dhe që përhapin ose justifikojnë ide dhe organizata neonaziste dhe fashiste; apo që në ndonjë mënyrë tjetër rrezikojnë rendin ligjor”.

Përhapja e simboleve dhe propagandës neonaziste e fashiste përmes sistemeve kompjuterike është po ashtu e dënueshme. Për personat fizikë që e shkelin ligjin, dënimet variojnë nga 5000 deri në 50.000 dinarë (nga 40 në mbi 400 euro), ndërsa për personat juridikë dënimet shkojnë nga 100.000 deri në 1.000.000 dinarë (nga rreth 850 deri në 8500 euro).

Dashko Milinoviqi beson se Serbia ka një kornizë të mirë ligjore, por që ajo zbatohet në mënyrë selektive. “Përdërisa aktivistët e majtë ose antinacionalistë arrestohen për postime ironike, duhet të ndodhë një e keqe e madhe dhe që publiku të bëjë zhurmë shtatë ditë për temat e neonacizmit që të njoftohen shërbimet shtetërore. Sepse thjesht, nuk duan të merren me ata”, thotë Milinoviq.

Epokë e re, zhanre të reja muzikore

E djathta ekstreme është futur edhe në zhanre të tjera muzikore në skenën globale të muzikës, si në neofolk, muzikë elektronike ose heavy metal. Në Evropën Lindore, ka një numër grupesh që kombinojnë zhanrin black metal me idetë e nacional-socializmit.

Grupi black-trash metal ‘Wolf’s

Hunger’ nga Novi Sadi i themeluar në fillim të viteve 2000 u desh të anulonte performancat e tij në disa raste, pas presionit të publikut ndaj organizatorëve për të mos lejuar koncertin e një bendi neonazist.

Ky grup ka edhe këngën “Great Serbia” (Serbia e madhe) me tekstin e mëposhtëm: “Forward to war for a greater Serbia, forward to war for a White Europe!” (Përpara në luftë për një Serbi të madhe, përpara në luftë për Evropën e bardhë). Në një përgjigje me shkrim për Radio Evropë e Lirë, ky bend thotë se nuk përhap “asnjë lloj ideje të nacional-socializmit ose fashizmit”.

“Kënga është krijuar 20 vjet më parë, ndësa ajo që përmendni është mënjeluar në çdo kuptim, ngase vet anëtar i tij është përjashtuar nga bendi me rastin e paraqitjes. Ne ishim fëmijë, ku kënaqeshim duke performuar dhe duke mos e ditur se çfarë thuhej në tekst, andaj grupi në atë kohë ishte në formacionin demo”, thuhet në përgjigjen e bendit.

Deri sot, grupi ka publikuar dy albume zyrtare – “Osveta u krvi” (Hakmarrja në gjak) më 2007 dhe “Bež’te živi vraćaju se mrtvi” (Ishin të gjallë, ktheheshin të vdekur) më 2016, ku këndohet kryesisht për mitologjinë e vjetër sllave dhe historinë e Serbisë nga Lufta e Parë Botërore.

Në pyetjen nëse bendi i tyre ka kontakte me organizata neonaziste, ata përgjigjen negativisht duke theksuar se kurrë nuk “kanë shprehur një interesim të tillë ose nuk kanë performuar në vende të tilla, dhe as që kanë qenë në rrethin e njerëzve të tillë”.

Rreziku për sigurinë e shtetit

Sipas Marija Gjoriqit, ka disa mijëra ekstremistë të djathtë në Serbi, të cilët janë të pranishëm në nivelin e simpatizantëve dhe në nivelin e anëtarëve aktivë.

Kur bëhet fjalë për shembuj të praktikës së mirë, Gjoriqi përmend Britaninë e Madhe dhe Gjermaninë, të cilat kanë përparuar në luftën kundër huliganizmit dhe që po përpiqen të përballen me të djathtën ekstreme në ushtri. Mirëpo, sipas saj, edhe këto vende nuk po mundën ta izolojnë ekstremizmin. “Është një bari i keq që vështirë çrrënjësonet dhe kjo është arsyeja që duhet të punojmë më shumë në parandalim se në sanksionim”, përfundon Gjoriqi.

Si përgjigje ndaj veprimeve të organizatave të ekstremist të djathtë, grupi i quajtur ‘Antifašisti Beograda’ (Antifashistët e Beogradit) organizuan një aktivitet rrugor në fillim të nëntorit, siç thonë ata, për ta identifikuar lokacionin në periferi të kryeqytetit, ku anëtarët e ekstremist të djathtë shkruanin mesazhe urrejtje dhe pikturonin murale me figurat e komandantëve çetnikë nga koha e Luftës së Dytë Botërore: Pavle Gjurišiq, Millan Nediq si dhe simbolet e organizatës fashiste ‘Zbor’ të themeluar nga Dimitrije Llotiqi. Muralet u rivizituan brenda 48 orësh.

(Ky artikull është publikuar në ‘Slobodna Evropa’)

ARSIM

« Nxënësit duhet të ndahen në ishuj »

Nxënësit duhet të ndahen në ‘ishuj’, edhe në grupe me katër veta. Ata duhet të jenë në gjendje të punojnë plotësisht vetëm, autonom, pa neve. Duhet t’i përgatisim të jenë autonomë, duhet pothuajse të zhdukemi, të paktën nga fusha e vizionit të tyre.

NGA NATHALIE QUINTANE*



Personalisht, gjithmonë kam dhënë diktme për detyrë. Është një moment vërtetë i lezetshëm. Fëmijët janë jashtëzakonisht të përqendruar, bëjnë vetëm një gjë në të njëjtën kohë. Duhet të përqendrohen se përndryshe t’ju ikë ndonjë fjalë. Të gjithë janë të renditur në një pozicion të njëjtë, nuk dëgjohet asnjë zhurmë. Me pak fjalë, është shumë relaksuese. Përpos kësaj, atyre ju duket sikur po bëjnë diçka të rëndësishme. Në çdo rast, ata veprojnë sikur e ndiejnë atë. Tundimi do të ishte të diktoja gjithçka në mënyrë që të ketë qetësi. Por nuk funksionon ashtu. Nëse dikton diçka tjetër përveç diktimit, paraqiten probleme. Do të ketë rrëmujë dhe zhurmë nëse dikton diçka që nuk është një diktim: këtë duhet ta kuptoni mirë dhe sa më shpejt të jetë e mundur nëse nuk doni të zhgënjeheni. Mund të ketë edhe momente me shumë përqendrim, individualisht ose në grup, por cilësia e heshtjes nuk krahasohet me atë që do ta keni kur bëni diktme. Kjo ndodh në klasat e mësuesve që janë shumë të rreptë, thuajse terrorizues. Mos mendoni se nuk ka më mësues të tillë, ka akoma, në numër të vogël, një për çdo shkollë. Ekziston një tjetër avantazh i diktimit: faza e korrigjimit. Nuk ka asgjë më të lehtë për t’u korrigjuar sesa një diktim: nuk nevojitet aspak përqendrim. Lirisht mund të dëgjoni radio ose të shikoni TV në të njëjtën kohë. Është punë mekanike. Përsëriten gjithmonë të njëjtat gabime në të njëjtat fjalë, atëherë mund t’i shikoni me shpejtësi të madhe të gjitha kopjet dhe brenda më së shumti një gjysmë ore i korrigjoni tridhjetë kopje. Nuk ka asgjë më të shpejtë për t’u korrigjuar sesa një diktim. I shënosi gabimet, ua dorëzoni fëmijëve, prindërit kuptojnë dhe të gjithë janë të kënaqur. Ka ndodhur që mësuesit të kenë pasur telashe për një shprehje të Artaud ose Zola, për një gjest ose humor të keqkuptuar, por asnjëherë askush nuk është ankuar për diktme të tepërta, së paku, unë kurrë nuk kam dëgjuar për raste të tilla.

Diktimi i vlerësuar me notën maksimale

20 është i vetmi ushtrim ku mund ta kesh notën – 40, dhe me sa di unë, kurrë nuk është befashuar askush. – 40 është ndoshta një nxënës disleksik. Në vitin 2010, ata ende bënin gjithë diktimin dhe zbritnin në ferr. Për shumicën e tyre mendohej se nuk ishin inteligjent. Papritmas, në një moment, kuptova se miqtë e mi më të mirë ishin të dobët në drejtshkrim dhe se jetoja me një disleksik, i cili gjatë shkollimit të tij ishte konsideruar si nxënës i dobët. Ai në fund kreu studime universitare, sikurse miqtë e mi të dobët në drejtshkrim. Pra, nëse ka njerëz të dobët në drejtshkrim dhe me potencial për ta zhvilluar një mendim dhe një kuptim të ndjeshëm ndaj botës, kjo do të thotë në të kundërtën se ka njerëz me drejtshkrim të shkëlqyeshëm që kanë mendime të kota ose që janë vërtetë budallenj. Apo jo?! Thuhet se në portale ku njoftohen çifte, bëhet edhe filtrimi sipas gabimeve drejtshkrimore: ata që shkruajnë pa gabime njoftohen me ata që shkruajnë pa gabime dhe bëhet kështoj një ‘përzgjedhje’ sipas shtresës shoqërore, duke nënkuptuar që të varfërit nuk janë në gjendje të shkruajnë dy rreshta në mënyrë të duhur dhe, më gjërësisht, nuk dinjë të shprehen. Në një farë mënyrë është kulmi i vrojtimit të gjërave, dhe shoqërisë – si funksionon ajo dhe siç besohet të jetë. Do të thotë ky është rezultati i njëqind viteve të shkollës publike dhe private, konfesionale ose laike dhe të detyrueshme, sepse përsa i përket drejtshkrimit dhe respektimit të tij, situata është e njëjtë në të dy anët.

Mund të gabojmë në gjininë e fjalës ‘peci’, por sigurisht jo në rregullin e pas-kajores me foljen ‘kam’ kur kundrinori i drejtë vendoset para foljes. Në këtë rast, të gjithë pajtohem që ta dish këtë rregull është një provë e inteligjencës pasi që nuk është e lehtë për t’u kuptuar (dhe në të vërtetë, është i pakuptueshëm). Kohët e fundit isha e befashuar që kolegë të mi gjithnjë e më shumë po bënin gabime në komunikimet e tyre (që nga ardhja e kompjuterëve, i shkruajmë njëri-tjetrit vazhdimisht). Edhe fëmijët e kanë

vërejtur atë: – A e keni vërejtur, zotëri T. bën shumë gabime! Unë mundohem ta zbus situatën: – Edhe Lamartine bënte shumë gabime dhe pastaj u bë deputet. Por, kuptohet, doja të thoja që zyrtarët nuk bëjnë asnjë gabim, jo sepse konkur-si shtetëror bën mrekullira dhe që sapo ta kaloni atë nuk bëni më gabime, por sepse drejtshkrimi është diçka që mbikëqyret jashtëzakonisht në shërbimin publik, si-kurse nëpunësit publikë që mbikëqyren jashtëzakonisht (kjo quhet devoir de ré-serve – detyrimi i rezervës).

Epo, asnjëri mendim nuk ishte i saktë. Nuk ka asnjë ligj që thotë se një zyrtar i shtetit duhet të ketë drejtshkrim të mirë. Ekziston në fakt legjenda e dekretit të vitit 1832. Por ky dekret i famshëm ka ekzistuar vetëm në mendjet e njerëzve. E njëj-ta gjë vlen edhe për detyrimin e rezervës në arsimin kombëtar. Nuk ka asnjë ligj. Ekziston detyrimi i rezervës në ushtri, por jo në arsimin kombëtar; në fakt kjo është arsyeja pse së fundmi një ministër ka përfshirë një amandament të ligjit, ku ai specifikon se tani ekziston një detyrim i “ekzemplaritetit” për mësuesit (për shkak se disa profesorë e kishin kundër-shtuar pak reformën e tij... dhe atij nuk i pëlqen kur profesorët nuk pajtohen me të). Kështu që as detyrimi i rezervës në arsimin kombëtar nuk ka ekzistuar kurrë, përveçse në mendje. Është mjaft shqetë-suese, kjo mani për shpikjen e ligjeve që nuk ekzistojnë në juridiksion, të cilët shkojnë të gjithë në të njëjtin drejtim, në më shumë kufizime. Për shembull (të pak-tën në fushën e arsimit kombëtar), askush nuk ëndërron për ligje, që do të sillnin më shumë liri ose më shumë barazi. Ndërtojmë në mënyrë të brendshme lig-je të cekta, ku përfshijmë ndëshkime. Më mbretëror se mbreti. Më sundimtar se shteti. Më menaxhues se institucioni. Më represiv se policia.

– Nga njëra anë, nxënësit duhet të ndahen në ishuj, domethënë në grupe nga katër nxënës, domethënë ata duhet të jenë në gjendje të punojnë plotësisht vetëm, autonom, pa neve. Duhet t’i përgatisim të jenë autonomë, duhet pothuajse të zhdukemi, të paktën nga fusha e vizionit të tyre. Atyre u japim një fletë A4 me fjali të gatshme për t’u plotësuar, për t’u manip- uluar, për të shpikur, për të përzier diçka, dhe shpejt e shpejt fshihiemi prapa kompj- uterit tonë dhe nuk lëvizim më derisa ata të kenë mbaruar. Nëse, vërtetë, ndonjë prej tyre (të cilin e quajmë menaxheri) vjen e na kërkon një këshillë, por vetëm në raste të veçanta, e referojmë atë në një grup tjetër i cili duket se e ka kuptuar më- simin: ata do t’ia shpjegojnë atij detyrën. Para se të përfundoj ora, megjithatë shko- jmë nga grupi në grup dhe, me një gjest të lehtë, shënojmë pika, pika me ngjyra.

Pika të gjelbërta për detyrat e bëra me sukses, pika të verdha, për detyrat mesa- tare dhe pika të kuqe nëse është dobët. Sigurisht një grup prej katër nxënësish nuk është kurrë krejtësisht i dobët; shu- micën e kohës, njëri nga të katërt e kupton sistemin dhe i shpërmdan pikat e gjelbërta.

Si mund të mos pajtohem me këtë version liridashës të mësimdhënies? Në rregull, e kemi një menaxher, i cili u quajt menaxher për ta nderuar dyqanin, dyqa- nin France, sipas shprehjes së (Colbert) Kolberit i cili donte ta drejtonte Francën si dyqanin e babait – por është një konce- sion minimal, apo jo !? Pra nxënësi bëhet mësuesi. Kjo është me të vërtetë mënyra më e mirë për të mësuar. Por kujdes: nëse inspeksioni zbulon se nuk i vendosni nx- ënësit në ishuj, se tavolinat janë akoma të rreshtuara përballë tabelës, me pak fjalë, se në fakt, thjesht jeni një anarkist i shfren- uar, atëherë do të largoheni nga puna; ose më saktë, do të ju sjellin telashe derisa të largoheni vet (motoja është: dekurajoni). A ka një sistem autoritar që do të kërkonte që ju të mos ishit? Është më e komplikuar se kaq. Sepse në fakt, në mënyrë krejt natyrale duhet të ketë disiplinë në klasën tuaj, të mos ketë aspak zhurmë, vetëm gumëzhime rreth pikave të mundshme të verdha, të gjelbërta, të kuqe. Edhe pse jeni fshehur pas kompjuterit tuaj. Sepse i keni shpërndarë fletat A4, dhe shpejt e shpejt jeni drejtuar kah kompjuteri juaj. U keni dëshiruar punë të mbarë 24 ose 31 nxënësve, dhe jeni kyçur në ENT, Espace numérique de travail (hapësira dixhitale e punës), flisni për veten, e përshkruani veten në ENT-në. Cila është gjendja, cili është kushti që e bën këtë të mundshme? Kushti është që 24 ose 31 nxënësit ta kenë integruar të gjithë autoritetin. Që të gjithë në të njëjtën kohë të jenë punon- jës dhe udhëheqës të vetvetes, që brenda secilit, punonjësi të pushojë sapo ta ketë kontrolluar udhëheqësi. Që udhëheqësi vigjilent vazhdimisht t’i ketë nën kontroll të rreptë punonjësit, a priori të dyshoj se të gjithë punonjësit fshehen për të push- uar. Duhet që punonjësi ta ndjej shikimin e shefit mbi supe, ose vërejtjen e shefit në veshin e tij. Një lloj kontrole e dyfishtë që do të thotë se, kur flisni, ju e dini që po i drejtoheni kolegut tuaj, në këtë rast shokut tuaj, dhe dikujt tjetër që gjindet në kokën tuaj... dhe çfarë vërej tani, ndërsa jam duke e shkruar këtë tekst (m’u kujtua papritmas), kuptoj, filloj të kuptoj se ky është pikërisht mekanizmi i mishërimit të inspeksionit (ju jeni duke u adresuar zyrtarisht 24 ose 31 nxënësve por edhe inspektorit – në thellësinë e zemrës suaj dhe në të vërtetë, kur flisni me nxënësit në fakt i folni inspektorit). Kështu, me- kanizmi i inkorporuar nga cilido zyrtar pikë e gjelbërt: pavarësisht a është ins- pektori fizikisht i pranishëm apo jo, ai është aty, gjithmonë pak në kokën time, për të kontrolluar që jam në vendin e

caktuar, me ishuj, autonomë, të vetëvlerë- suar, të heshtur, gumëzhitës, punëtorë, të pamëshirshëm, të kontrolluar nga njëri, të kontrolluar nga tjetri.

*Shkrimtare dhe mësimdhënëse. Au- tore e Un hamster à l’école, botuar në shtëpinë botuese La Fabrique, Paris, më 14 janar, nga i cili roman janë nxjerrur këto dy tekste.

REDAKSIA E BOTIMIT NË SHQIP

Botues: Instituti “Musine Kokalari” - Prishtinë (Kosovë)

Drejtor: Belgzim Kamberi

Kryeredaktor: Ardit Rada

Redaksia: Leart Kola, Shkodran Hoti

Përkthimi: Lemane Muriqi, Nerimane Kamberi, Bora Deda, Belgzim Kamberi

Layout design: Josif Xhemali

Email: botadiplomatie@gmail.com

Édité par la SA Le Monde diplomatique.
Actionnaires: Société éditrice du Monde,
Association Gunter Holzmann,
Les Amis du Monde diplomatique
1, avenue Stephen-Pichon, 75013 Paris
Tél. : 01-53-94-96-01. Télécopieur : 01-53-94-96-26
Courriel : secretariat@monde-diplomatique.fr
Site Internet : www.monde-diplomatique.fr

Directoire: Serge HALIMI,
président, directeur de la publication
Autres membres: Vincent CARON, Bruno LOMBARD,
Pierre RIMBERT, Anne-Cécile ROBERT
Directrice des relations et des éditions internationales :
Anne-Cécile ROBERT
Secrétaire générale :
Anne CALLAIT-CHAVANEL

Directeur de la rédaction : Serge HALIMI
Rédacteur en chef: Benoît BRÉVILLE
Rédacteurs en chef adjoints:
Martine BULARD, Renaud LAMBERT
Cheffe d’édition : Mona CHOLLET
Rédaction : Akram BELKAÏD, Philippe DESCAMPS,
Evelynne PIEILLER, Hélène RICHARD,
Pierre RIMBERT, Anne-Cécile ROBERT
Cartographie : Cécile MARIN
Site Internet : Guillaume BAROU, Thibault HENNETON
Conception artistique:
Maria IERARDI, Boris SÉMENIAKO
(avec la collaboration
de Delphine LACROIX pour l’iconographie)
Rédacteur documentaliste : Olivier PRONET
Mise en pages et photographie:
Jérôme GRILLIÈRE, Patrick PUECH-WILHEM
Correction : Xavier MONTHEÂRD, Sarah ZHIRI

Directeur de la gestion : Bruno LOMBARD
Directeur commercial,
chargé de la diffusion numérique: Vincent CARON
Contrôle de gestion : Zaïa SAHALI
Secrétariat : Yuliya DAROUKA (9621),
Sophie DURAND-NGÔ, attachée communication
et développement (9674), Eleonora FALETTI (9601)
Courriel : prenom.nom@mmonde-diplomatique.fr
Fondateur : Hubert BEUVE-MÉRY. Anciens directeurs :
François HONTI, Claude JULIEN, Ignacio RAMONET

Publicité : Hélène FAVERIE (01-57-28-38-03)

Diffusion, mercatique : Brigitte BILLIARD, Saveria COLOSIMO-
MORIN, Sophie GERBAUD, Sabine GUDE, Carole MERCERON,
Christiane MONTILLET
Relations marchands de journaux (numéro vert):
0805-050-147
Service relations abonnés
● Depuis la France: 03-21-13-04-32 (non surtaxé)
www.monde-diplomatique.fr
● Depuis l’étranger : (33) 3-21-13-04-32
*Reproduction interdite de tous articles,
sauf accord avec l’administration*
© ADAGP, Paris, 2019,
pour les œuvres de ses adhérents
Prix de l’abonnement annuel à l’édition imprimée :
France métropolitaine : 59 €
Autres destinations : www.monde-diplomatique.fr/abo

FAQE 2-3-4
Udhëkryqi i vendnumërimit ballkanik,
**INTERVISTUAN: SHKODRAN HOTI
DHE BELGZIM KAMBERI**

FAQE 4
Kush do do të jetë armiku i radhës?,
NGA SERGE HALIMI

FAQE 5
Qorrsokaku i politikave identitare,
**NGA STÉPHANE BEAUD ET
GÉRARD NOIRIEL***

FAQE 6
Për një parti të re të majtë,
NGA LEART KOLA*

FAQE 7
Epoka e financave autoritare,
**NGA MARLÈNE BENQUET DHE
THÉO BOURGERON***

FAQE 8-9
Trajnim sipas stilit amerikan për
drejtuesit kinezë,
**NGA ALESSIA LO PORTO-
LEFÉBURE***

FAQE 10
Bomba e tregtisë së lirë në Azi,
NGA MARTINE BULARD*

FAQE 11
Pse e kemi të vështirë ta shkruajmë
historinë tonë?,
NGA BEN ANDONI

FAQE 12-13
Rusia në Afrikë, një rikthim në iluzion
optik?,
NGA ARNAUD DUBIEN*

FAQE 14
A ishte Gjermania lindore antisemite?,
NGA SONIA COMBE*

FAQE 15
Mësimi i “Vargjeve Satanike”,
NGA LAURENT BINET

FAQE 16-17
Në kufirin greko-turk, epiqendër
tensionesh,
**NGA KORRESPONDENTJA JONË
ÉLISA PERRIGUEUR***

FAQE 18-19
Bendet muzikore neonaziste serbe të
përkëdhelura nga shteti,

**NGA DUSHAN KOMARÇEVIQ DHE MAJA
ZHIVANOVIQ**

FAQE 20
« Nxënësit duhet të ndahen në ishuj »,

NGA NATHALIE QUINTANE*